



**Strengthening Teaching Competences
in Higher Education
in Natural and Mathematical Sciences**

Co-funded by the
Erasmus+ Programme
of the European Union



LIST OF NEW AND INNOVATED SUBJECTS ACCREDITED DURING THE PROJECT ELIGABILITY PERIOD



**UNIVERSITY OF GJIROKASTER
FACULTY OF NATURAL SCIENCES
AND
DEPARTMENT OF EDUCATION**

Authors:

Irma Gjollehi

Romeo Mano



List of innovative courses

1. MASTER IN TEACHING ENGLISH IN LOWER SECONDARY EDUCATION

- **Subject:** Communication and Information Technology in Education
- **Professor:** Doc. Dr. Isidor Kokalari

2. MASTER IN TEACHING MATHEMATICS AND INFORMATICS IN LOWER SECONDARY EDUCATION

- **Subject:** Information Technology in Teaching
- **Professor:** Dr. Antuela Sinani

3. PROFESSIONAL MASTER IN TEACHING FOR SPECIAL PURPOSES

- **Subject:** Inclusion in Education
- **Professor:** Prof. assoc. Mimoza Çarka

4. MASTER IN TEACHING IN LOWER SECONDARY EDUCATION

- **Subject:** Curriculum Development
- **Professor:** Prof. assoc. Mimoza Çarka

5. MASTER IN TEACHING IN LOWER SECONDARY EDUCATION

- Improvement of Learning and Critical Thinking
- **Professor:** Dr. Zhulieta Lilo

6. PROFESSIONAL MASTER IN TEACHING ELEMENTARY EDUCATION

- School Psychology
- **Professor:** Dr. Zhulieta Lilo

7. MASTER IN TEACHING BIO-CHEMISTRY IN LOWER SECONDARY EDUCATION

- Research in Education
- **Professor:** Dr. Loreta Mamani

8. MASTER IN TEACHING FOR SPECIAL PURPOSES

- Methodology of Communication and Information Technology in Education
- **Professor:** Dr. Loreta Mamani



**Strengthening Teaching Competences
in Higher Education
in Natural and Mathematical Sciences**


Co-funded by the
Erasmus+ Programme
of the European Union



9. MASTER IN TEACHING MATHEMATICS AND INFORMATICS IN LOWER SECONDARY EDUCATION

- Research Seminar
- Professor: Romeo Mano

PROGRAMI I LËNDËS
KOMUNIKIMI DHE TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT NË EDUKIM

Titullari / Pedagogu i lëndës: Isidor Kokalari, Doc. Dr. 
Ngarkesa: 8 ECTS, 90 orë në klasë, (45 orë leksion, 45 orë seminar)
Viti akademik / semestri kur zhvillohet: 2022-2023 SEMESTRI I
Lloji i lëndës: E detyrueshme
Programi i Studimit: Master në mësuesi për AMU në gjuhë angleze
Adresa elektronike e titullarit/pedagogut të lëndës: ikokalari@uogj.edu.al
Kodi i etikës: Pedagogu dhe studenti duhet të respektojë rigorozisht tërësinë e rregullave, pritshmërive dhe sanksioneve përkatëse të parashikuara në rregulloren e UGJ-së dhe të programit të studimit

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

A – Komunikimi: Te kuptohen teknikat verbale dhe jo verbale të komunikimit. Te përdoren teknikat e komunikimit në përgatitjen e materialeve mesimore për studentet. Te kuptohet se si dallimet kulturore e gjinore ndikojnë në komunikimin në klase.

B – Teknologjia: Te aplikohen kompjuterat dhe teknologjite që lidhen me to në mbështetje të mesimdhënies. Te integrohen teknologjite e reja në mbështetje të strategjive të mesimdhënies dhe përgatitjes së materialeve didaktike. Te aplikohen mjetet teknologjike për rritjen profesionale dhe të produktivitetit në kryerjen e kerkimit shkencor. Përdorimi i internetit për vjeljen dhe filtrimin e informacionit. Përdorimi i bazave të të dhënave për vjele dhe përdorur të dhëna për qëllime edukimi. Përdorimi i mjeteve kompjuterike për të krijuar prezantime. Përdorimi i programeve kompjuterike për të krijuar dhe përdorur të dhëna e për të publikuar rezultatet.

KONCEPTET THEMELORE:

1. Teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK).
2. Përdorimet, përparësitë, mangësitë e përdorimit të TIK në mesimdhënie
3. Aftësitë dhe kompetencat e nxënësve dhe mësuesit në përdorimin e TIK në mesimdhënie/dhënie
4. Mënyra, platforma kompjuterike dhe mjete të përdorimit të TIK në mesimdhënie e gjuhës së huaj

TEMAT E LËNDËS:

Tema I: Kompjuterat në botën tonë (desktop, laptop, tablet, smartphone, etj). Përdorimet e kompjuterit (shtëpi, arsim, biznes, shëndetësi, qeverisje, industri). Hardware dhe software.

Introduction to Computers, P.Norton, 2-47

Tema II: Ndërveprimi me kompjuterin. Përdorimi i tastierës dhe mouse-t. Mënyra të tjera për të futur të dhëna (touch screen, leva e lojrave, lexuesi i barkodeve, skanera, mikrofova, kamera, etj).

Introduction to Computers, P.Norton, 48-85

Tema III: Depozitimi i të dhënave. Llojet e pajisjeve memorizuese. Printimi dhe printerat. Matja dhe përmirësimi i punës së kompjuterit.

Introduction to Computers, P.Norton, 164-203

Tema IV: Sistemet e operimit. Ndërfaqja grafike (dritaret, start menu, taskbar, desktop).

Introduction to Computers, P.Norton, 204-241

Tema V: Bazat e rrjetit. Komunikimi i të dhënave në rrjet

Introduction to Computers, P.Norton, 242-283

Tema VI: Shërbimi i internetit dhe e-mailit.

Introduction to Computers, P.Norton, 284-329

Tema VII: Mbrojtja e privatësisë së të dhënave kompjuterike

Introduction to Computers, P.Norton, 476-517

Tema VIII: Teknologjia në mësimdhënien e gjuhëve të huaja. Qëndrimet ndaj teknologjisë. Aplikimi i teknologjisë në klasë. Aftësitë dhe pajisjet e nevojshme. Smart board. Smart phone. Smart table.

How to teach english with technology, G.Dudeny, N.Hockly, 5-14

Teknologjia digjitale në arsim, E.Tartari, 183-200

Tema XIX: Përdorimi i TIK për të nxitur mësimnxënien e Gjuhës Agleze

The ICT Handbook for Primary Teachers, D.Hall, 15-26

Tema X: Burimet dhe mjetet TIK që mund të përdoren në mësimdhënie

The ICT Handbook for Primary Teachers, D.Hall, 184-222

Tema XI: Programet e përpunimit të tekstit në klasë. Pse duhen përdorur? Krijimi i materialeve didaktike nga mësuesit. Përdorimi nga nxënësit.

How to teach english with technology, G.Dudeny, N.Hockly, 15-26

Tema XII: Përdorimi i faqeve të internetit në klasë. Si të gjejmë faqe interneti të dobishme. Planifikimi i mësimi duke përdorur informacin nga interneti.

How to teach english with technology, G.Dudeny, N.Hockly, 27-43

Tema XIII: Si të përdorim e-mail. Përfitimet nga përdorimi i e-mail. Aftësitë bazë për përdorimin e e-mailit. Përdorimi i emailit me nxënësit brenda dhe jashtë klasës.

How to teach english with technology, G.Dudeny, N.Hockly, 62-70

Tema XIV: Si të përdorim "chat" në mësimdhënien e gjuhëve të huaja. Llojet dhe programet e "chat". Përparësitë e përdorimit. Si të nisim ta përdorim "chat" me tekst apo me audio në mësimdhënie.

How to teach english with technology, G.Dudeny, N.Hockly, 71-85

Tema XV: Blog, rrjetet sociale, "wiki" në mësimdhënien e gjuhëve të huaja. Si të fillojmë të përdorim një "wiki" me nxënësit.

How to teach english with technology, G.Dudeny, N.Hockly, 86-102

Tema XVI: Mjetet online që mund të përdoren në mësimdhënien e gjuhëve të huaja. Fjalorët, përkthyesit elektronikë, enciklopeditë.

How to teach english with technology, G.Dudeny, N.Hockly, 86-102

Tema XVII: Programet mësimore. CD-ROM dhe DVD për mësimdhënien e gjuhës së huaj. Testimet kompjuterike. Portofoli elektronik. Dërrasat interaktive.

How to teach english with technology, G.Dudeny, N.Hockly, 113-125

Tema XVIII: Prodhimi i materialeve elektronike didaktike. Çfarë janë materialet elektronike? Materialet online. Çfarë janë dhe si përdoren mjetet autorizuese për të prodhuar materialet elektronike.

How to teach english with technology, G.Dudeny, N.Hockly, 126-135

Tema XIX: E-learning. Modelet e e-learning. Mësimdhënia dhe trajnimi online. Dizajnimi i kursit për mësimnxënie online. Si të nisim mësimnxënie online. Trajnimi i mësuesve. Grupet online të diskutimit.

How to teach english with technology, G.Dudeny, N.Hockly, 136-147

Teknologjia digjitale në arsim, E.Tartari, 99-112

Tema XX: Modele të e-learning.

The ICT Handbook for Primary Teachers, D.Hall, 64-109

Tema XXI: Ndikimi i të mësuarit gjatë gjithë jetës nëpërmjet e-learning

Education for the 21st Century: Impact of ICT and Digital Resources, D. Kumar, & J. Turner, 1-7

Tema XXII: Siguria e informacionit në mjedisin e të mësuarit online, e-learning

Education for the 21st Century: Impact of ICT and Digital Resources, D. Kumar, & J. Turner, 345-350

Tema XXIII: Gjendja aktuale dhe përgatitja për të ardhmen e të mësuarit me TIK. E ardhmja e të mësuarit online. Të nxënëët virtual. Të nxënëët multimedial.

How to teach english with technology, G.Dudeney, N.Hockly, 148-158

Tema XXIV: Të mësuarit në distancë. Bazat e mësimit online. Mësimdhënia e një kursi tërësisht online.

Personeli mbështetës dhe trajnimet. Çfarë i ofron mësimi online mësuesit. Burimet e institucionit.

Teaching online: a practical guide, S.Ko, S.Rossen, 37-54

Teknologjia digjitale në arsim, E.Tartari, 121-129

Tema XXV: Të mësuarit e hapur. Të mësuarit virtual. Ndërtimi dhe zhvillimi i një kursi online. Rubrika dhe udhëzime për krijimin e kursit online.

Teaching online: a practical guide, S.Ko, S.Rossen, 56-75

Teknologjia digjitale në arsim, E.Tartari, 130-133

Tema XXVI: Materiale mësimore të përgatitur nga instruktori: tekst, prezantime, material audio-vizuale, simulime, eksperimente. Përzgjedhja e librave dhe software mësimore.

Teaching online: a practical guide, S.Ko, S.Rossen, 84-108

Tema XXVII: Bashkëpunimi me të tjerë për krijimin e kursit online. Mësimdhënia e bazuar në kompetenca dhe përshtatja e moduleve mësimore.

Teaching online: a practical guide, S.Ko, S.Rossen, 115-134

Tema XXVIII: Krijimi i një syllabusi efektiv për mësim online. Pjesëmarrja në klasën online dhe kriteret e vlerësimit të studentëve. Planifikimi i aktivitetit mësimor.

Teaching online: a practical guide, S.Ko, S.Rossen, 135-160

Tema XXIX: Aktiviteti i studentëve në mjedisin online. Ndarja në grupe dhe veprimtari në grup. Monitorimi dhe vlerësimi i grupit.

Teaching online: a practical guide, S.Ko, S.Rossen, 194-234

Tema XXX: Burimet e hapura mësimore, pronësia intelektuale dhe e drejta e autorit. Disa hapa praktikë për të mbrojtur punën akademike. Verifikimi i përdorimit të paautorizuar të produktit akademik.

Teaching online: a practical guide, S.Ko, S.Rossen, 247-260

Tema XXXI: MS TEAMS: krijimi dhe menaxhimi i ekipit. Krijimi/fshirja e kanaleve. Planifikimi dhe regjistrimi i takimit. Dërgimi/marrja dhe kopjimi/fshirja e skedarëve.

Hands-On Microsoft Teams: A practical guide to enhancing enterprise collaboration with Microsoft Teams and Office 365, J.Ferreira, 84-164

Tema XXXII: Google Classroom: Login. Krijimi i një klase. Organizimi i materialeve të klasës. Shtimi i studentëve në klasë. Menaxhimi i lajmërimeve. Dërgimi / marrja e detyrave. Udhëzime për privatësinë dhe copyright.

Google Classroom for teachers: the ultimate guide to digital learning, G.Page, 19-59

Tema XXXIII: Zoom: Përgatitja dhe nisja e takimit, planifikimi dhe regjistrimi i takimit. Paraqitja e ekranit në takim. Opsioni whiteboard. Puna në grupe. Dërgimi i detyrave.

Zoom For Online Teaching: Learn How To Use Zoom For Video Classes, Webinars, Meetings And Video Conferences For Distance And Remote Teaching, M.Dale, 8-35

Tema XXXIV: Mjedis i personalizuar për e-learning duke marrë në konsideratë cilësitë e nxënësve
Education and Technology for a BetterWorld, A.Tatnall, A.Jones, 48-57

Tema XXXV: Përdorimi i TIK për nevojat e fëmijëve me aftësi të veçanta
The ICT Handbook for Primary Teachers, D.Hall, 110-155

Tema XXXVI: Ndhimesa e paketave elektronike për kontrollin e drejtshkrimit dhe gramatikës në të shkruarin e gjuhëve të huaja
Education and Technology for a BetterWorld, A.Tatnall, A.Jones, 247-255

Tema XXXVII: Implementimi i përdorimit të mjeteve TIK në trajnimin e mësuesve. Mësuesi dhe teknologjia. Njohuritë teknologjike, pedagogjike dhe të përmbajtjes. Standardet e mësuesit për zbatimin e TIK në shkollë. Metodat e mësimdhënies me bazë TIK.
Education for the 21st Century: Impact of ICT and Digital Resources, D. Kumar, & J. Turner, 387-393
Teknologjia digjitale në arsim, E.Tartari, 137-177

Tema XXXVIII: Programi PowerPoint (Hartimi i një prezantimi të ri, dhe arshivimi i tij. Hapja, mbyllja, fshirja e një prezantimi dhe dalja nga programi).
Teach Yourself PowerPoint 2010, W.Wood, 46-57

Tema XXXIX: Shkrimi dhe formatimi i tekstit në prezantim (madhësia, lloji, ngjyra, efektet mbi tekstin).
Teach Yourself PowerPoint 2010, W.Wood, 58-79

Tema XL: Shtimi dhe formatimi i elementeve shtesë në një slide (tabela, grafikë, vizatime, forma, wordart).
Teach Yourself PowerPoint 2010, W.Wood, 94-119

Tema XLI: Organizimi i slide-ve (kopjimi, zhvendosja, fshirja, shtimi i një slide në prezantim)
Teach Yourself PowerPoint 2010, W.Wood, 184-197

Tema XLII: Përdorimi i animacioneve të elementeve të veçantë dhe të slajdave në tërësi në një prezantim. Printimi i një prezantimi.
Teach Yourself PowerPoint 2010, W.Wood, 198-217

Tema XLIII: Shtimi dhe manipulimi i elementëve medialë (foto, video, screenshot, audio)
Teach Yourself PowerPoint 2010, W.Wood, 218-241

Tema XLIV: Konfigurimi i prezantimit, shtimi i komenteve, konfigurimi i kohës së ekzekutimit, paraqitja e prezantimit
Teach Yourself PowerPoint 2010, W.Wood, 2010, 242-259

Tema XLV: Printimi (slide, shënime, etj) dhe publikimi i prezantimit
Teach Yourself PowerPoint 2010, W.Wood, 260-289

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE:

FREKUENTIMI: Frekuentim i detyruar deri në masën 75 % të seancave të seminareve.

KONTROLL I VAZHDUESHËM: Vlerësim i vazhduar dhe provim final me shkrim në përfundim të lëndës

Provimi final 80%

Vlerësim i vazhduar 20% (aktivizimi në seminare / detyrë kursi)

LITERATURA

Literatura bazë e detyrueshme:

1. How to teach english with technology, G.Dudenev, N.Hockly, 2008, ISBN: 978-1-4058-4773-5
2. Teknologjia digjitale në arsim, E.Tartari, 2020, ISBN: 978-9928-267-34-4
3. Introduction to Computers, P.Norton. 2006, ISBN: 978-0-07-059374-9
4. Teach Yourself PowerPoint 2010, W.Wood, 2010, ISBN: 978-0-470-57766-0
5. Teaching online: a practical guide, S.Ko, S.Rossen, 2017. ISBN: 978-0-203-42735-4

Literatura e rekomanduar:

6. Education and Technology for a BetterWorld, A.Tatnall, A.Jones, 2009, ISBN: 978-3-642-03114-4
7. The ICT Handbook for Primary Teachers. D.Hall, Routledge 2010. ISBN 0-203-86293-7
8. Education for the 21st Century: Impact of ICT and Digital Resources, D. Kumar, and J. Turner, 2006, ISBN: 9780-387-34627-4
9. Hands-On Microsoft Teams: A practical guide to enhancing enterprise collaboration with Microsoft Teams and Office 365. J.Ferreira, 2020, ISBN: 978-1839213984
10. Google Classroom for teachers: the ultimate guide to digital learning. G.Page. 2020, ISBN: 979-8645334789
11. Zoom For Online Teaching: Learn How To Use Zoom For Video Classes, Webinars, Meetings And Video Conferences For Distance And Remote Teaching. M.Dale, 2020, ISBN: 979-8677303692
12. Forcimi i kompetencave të mësimdhënies: Kompetencat dixhitale, *Material didaktik i përgatitur në kuadrin e projektit TECOMP*, http://www.tecomp.ni.ac.rs/download/IT_technology_Albanian.pdf

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS

Studentët janë të detyruar të veprojnë në përputhje me, dhe të respektojnë në mënyrë rigoroze tërësinë e rregullave, pritshmërive dhe sanksioneve përkatëse të parashikuara në rregulloren e UGJ-së për t'u sjellë me integritet akademik mbështetur në ndershtetëri.

Studentët janë të detyruar :

- Të mos kopjojnë apo japin kopje në provim
- Të mos kopjojnë dhe paraqesin punën e dikujt tjetër
- Të mos fabrikojnë apo manipulojnë të dhënat
- Të respektojnë integritetin dhe dinjtetin njerëzor & profesional të personelit akademik dhe atij ndihmës
- Të respektojnë integritetin dhe dinjtetin njerëzor & profesional të studenteve të tjerë

Në raste shkeljesh të këtyre rregullave studentët penalizohen siç parashikon rregullorja e UGJ-së dhe rregullorja e programit të studimit.

Miratoi

Përgjegjësi i Njesisë Bazë / Departamentit të Gjuhëve të Huaja

Prof. asoc. Dr. Herallamb Miçoni



TIK NË MËSIMDHËNIE

Titullari / Pedagogu i lëndës: Antuela SINANI, Dr. *ASU*
Ngarkesa: 6 ECTS, 56 orë në auditor, (28 orë leksion, 28 orë seminar)
Viti akademik / semestri kur zhvillohet: 2022-2023 SEMESTRI III
Lloji i lëndës: E detyrueshme
Programi i Studimit: Master në Mësuesi në arsimin e mesëm të ulët në Matematikë-Informatikë
Adresa elektronike e titullarit/pedagogut të lëndës: asinani@uogj.edu.al
Kodi i etikës: Pedagogu dhe studenti duhet të respektojë rigorozisht tërësinë e rregullave, pritshmërive dhe sanksioneve përkatëse të parashikuara në rregulloren e UGJ-së dhe të programit të studimit

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

A – Komunikimi: Te kuptohen teknikat verbale dhe jo verbale te komunikimit. Te perdoren teknikat e komunikimit ne pergatitjen e materialeve mesimore per studentet. Te kuptohet se si dallimet kulturore e gjinore ndikojne ne komunikimin ne klase.

B – Teknologjia: Te aplikohen kompjuterat dhe teknologjite qe lidhen me to ne mbeshtetje te mesimdhënies. Te integrohen teknologjite e reja ne mbeshtetje te strategjive te mesimdhënies dhe pergatitjes se materialeve didaktike. Te aplikohen mjetet teknologjike per rritjen profesionale dhe te produktivitetit ne kryerjen e kerkimit shkencor. Perdorimi i internetit per vjeljen dhe filtrimin e informacionit. Perdorimi i bazave te te dhenave per vjele dhe perdorur te dhena per qellime edukimi. Perdorimi i mjeteve kompjuterike per te krijuar prezantime. Perdorimi i programeve kompjuterike per te krijuar dhe perdorur te dhena e per te publikuar rezultatet.

KONCEPTET THEMELORE:

1. Teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK).
2. Përdorimet, përparësitë, mangësitë e përdorimit të TIK në mësimdhënie
3. Aftësitë dhe kompetencat e nxënësve dhe mësuesit në përdorimin e TIK në mësimnxënie/dhënie
4. Mënyra, platforma kompjuterike dhe mjete të përdorimit të TIK në mësimdhënien

TEMAT E LËNDËS:**Tema 1**

Kompjuterat në botën tonë (desktop, laptop, tablet, smartphone, etj). Përdorimet e kompjuterit (shtëpi, arsim, biznes, shëndetësi, qeverisje, industri). Hardware dhe software. Mënyra të tjera për të future të dhëna (touch screen, leva e lojrave, lexuesi i barkodeve, skanera, mikrofona, kamera, etj).

Introduction to Computers, P.Norton, 2-85

Tema 2

Sistemet e operimit. Ndërfaqja grafike (dritaret, start menu, taskbar, desktop). Bazat e rrjetit. Komunikimi i të dhënave në rrjet

Introduction to Computers, P.Norton, 204-283

Tema 3

Si të përdorim e-mail. Përfitimet nga përdorimi i e-mail. Aftësitë bazë për përdorimin e e-mailit. Përdorimi i emailit me nxënësit brenda dhe jashtë klasës.

How to teach english with technology, G.Dudeney, N.Hockly, 62-70

Tema 4

Depozitimi i të dhënave. Llojet e pajisjeve memorizuese. Printimi dhe printerat. Matja dhe përmirësimi i punës së kompjuterit. Shërbimi i internetit dhe e-mailit.

Introduction to Computers, P.Norton, 164-203; 284-329

Tema 5

Mbrojtja e privatësisë së të dhënave kompjuterike

Introduction to Computers, P.Norton, 476-517

Tema 6

Prodhimi i materialeve elektronike didaktike. Çfarë janë materialet elektronike? Materialet online. Çfarë janë dhe si përdoren mjetet autorizuese për të prodhuar materiale elektronike.

How to teach english with technology, G.Dudeney, N.Hockly, 126-135

Tema 7

Burimet dhe mjetet TIK që mund të përdoren në mësimdhënie

The ICT Handbook for Primary Teachers, D.Hall, 184-222

Tema 8

Ndërtimi dhe zhvillimi i një kursi online. Rubrika dhe udhëzime për krijimin e kursit online.

Teaching online: a practical guide, S.Ko, S.Rossen, 56-75

Tema 9

Bashkëpunimi me të tjerë përkrijimin e kursit online. Mësimdhënia e bazuar në kompetenca dhe përshtatja e moduleve mësimore.

Teaching online: a practical guide, S.Ko, S.Rossen, 115-134

Tema 10

Implementimi i përdorimit të mjeteve TIK në trajnimin e mësuesve

Education for the 21st Century: Impact of ICT and Digital Resources, D. Kumar, & J. Turner, 387-393

Tema 11

Programet e përpunimit të tekstit në klasë. Pse duhen përdorur? Krijimi i materialeve didaktike nga mësuesit. Përdorimi nga nxënësit.

How to teach english with technology, G.Dudeney, N.Hockly, 15-26

Tema 12

Përdorimi i faqeve të internetit në klasë. Si të gjejmë faqe internet të dobishme. Planifikimi i mësimit duke përdorur informacin nga interneti.

How to teach english with technology, G.Dudeney, N.Hockly, 27-43

Tema 13

E-learning. Mësimdhënia dhe trajnimi online. Dizajnimi i kursit për mësimnxënie online. Si të nisim mësimnxënie online. Trajnimi i mësuesve. Grupet online të diskutimit.

How to teach english with technology, G.Dudeney, N.Hockly, 136-147

Tema 14

Modele të e-learning.

The ICT Handbook for Primary Teachers, D.Hall, 64-109

Tema 15

Ndikimi i të mësuarit gjatë gjithë jetës nëpërmjet e-learning

Education for the 21st Century: Impact of ICT and Digital Resources, D. Kumar, & J. Turner, 1-7

Tema 16

Siguria e informacionit në mjedisin e të mësuarit online, e-learning

Education for the 21st Century: Impact of ICT and Digital Resources, D. Kumar, & J. Turner, 345-350

Tema 17

Përdorimi i TIK për nevojat e fëmijëve me aftësi të veçanta

The ICT Handbook for Primary Teachers, D.Hall, 110-155

Tema 18

Mjedisi i personalizuar për e-learning duke marrë në konsideratë cilësitë e nxënësve

Education and Technology for a BetterWorld, A.Tatnall, A.Jones, 48-57

Tema 19

Bazat e mësimit online. Mësimdhënia e një kursi tërësisht online. Personeli mbështetës dhe trajnimet. Çfarë i ofron mësimi online mësuesit. Burimet e institucionit.

Teaching online: a practical guide, S.Ko, S.Rossen, 37-54

Tema 20

Gjendja aktuale dhe përgatitja për të ardhmen e të mësuarit me TIK. E ardhmja e të mësuarit online. Të nxënësit

- virtual. Të nxënësit multimedial.

How to teach english with technology, G.Dudeney, N.Hockly, 148-158

Tema 21

Përdorimi i TIK për të nxitur mësimnxënien.

The ICT Handbook for Primary Teachers, D.Hall, 15-26

Tema 22

Ndihmesa e paketave elektronike për kontrollin e drejtshkrimit dhe gramatikës në të shkruar

Education and Technology for a BetterWorld, A.Tatnall, A.Jones, 247-255

Tema 23

MS TEAMS: krijimi dhe menaxhimi i ekipit. Krijimi/fshirja e kanaleve. Planifikimi dhe regjistrimi i takimit.

Dërgimi/marrja dhe kopjimi/fshirja e skedarëve.

Hands-On Microsoft Teams: A practical guide to enhancing enterprise collaboration with Microsoft Teams and Office 365, J.Ferreira, 84-164

Tema 24

Google Classroom: Login. Krijimi i njëklase. Organizimi i materialeve të klasës. Shtimi i studentëve në klasë.

Menaxhimi i lajmërimeve. Dërgimi / marrja e detyrave. Udhëzime për privatësinë dhe copyright.

Google Classroom for teachers: the ultimate guide to digital learning, G.Page, 19-59

Zoom: Përgatitja dhe nisja e takimit, planifikimi dhe regjistrimi i takimit. Paraqitja e ekranit në takim. Opsioni whiteboard. Puna në grupe. Dërgimi i detyrave.

Zoom For Online Teaching: Learn How To Use Zoom For Video Classes, Webinars, Meetings And Video Conferences For Distance And Remote Teaching, M.Dale, 8-35

Tema 25

Ndërtimi dhe zhvillimi i një kursi online. Rubrika dhe udhëzime për krijimin e kursit online.

Teaching online: a practical guide, S.Ko, S.Rossen, 56-75

Tema 26

Materiale mësimore të përgatitur nga instruktori: tekst, prezantime, material audio-vizuale, simulime, eksperimente. Përzgjedhja e librave dhe software mësimore.

Teaching online: a practical guide, S.Ko, S.Rossen, 84-108

Tema 27

Krijimi i një syllabusi efektiv për mësim online. Pjesëmarrja në klasën online dhe kriteret e vlerësimit të studentëve. Planifikimi i aktivitetit mësimor.

Teaching online: a practical guide, S.Ko, S.Rossen, 135-160

Tema 28

Aktiviteti i studentëve në mjedisin online. Ndarja në grupe dhe veprimtari në grup. Monitorimi dhe vlerësimi i grupit.

Teaching online: a practical guide, S.Ko, S.Rossen, 194-234

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE:

FREKUENTIMI: Frekuentim i detyruar deri në masën 75 % të seanceve të seminareve.

KONTROLL I VAZHDESHËM: Vlerësim i vazhduar dhe provim final me shkrim në përfundim të lëndës

Provimi final 80%

Vlerësim i vazhduar 20%

LITERATURA

Literatura bazë e detyrueshme:

1. How to teach english with technology, G.Dudeney, N.Hockly, 2008, ISBN: 978-1-4058-4773-5
2. Introduction to Computers, P.Norton, 2006, ISBN: 978-0-07-059374-9
3. Teach Yourself PowerPoint 2010, W.Wood, 2010, ISBN: 978-0-470-57766-0
4. Teaching online: a practical guide, S.Ko, S.Rossen, 2017, ISBN: 978-0-203-42735-4

Literatura e rekomanduar:

5. Education and Technology for a BetterWorld, A.Tatnall, A.Jones, 2009, ISBN: 978-3-642-03114-4
6. The ICT Handbook for Primary Teachers, D.Hall, Routledge 2010, ISBN 0-203-86293-7
7. Education for the 21st Century: Impact of ICT and Digital Resources, D. Kumar, and J. Turner, 2006, ISBN: 9780-387-34627-4
8. Hands-On Microsoft Teams: A practical guide to enhancing enterprise collaboration with Microsoft Teams and Office 365, J.Ferreira, 2020, ISBN: 978-1839213984
9. Google Classroom for teachers: the ultimate guide to digital learning, G.Page, 2020, ISBN: 979-8645334789
10. Zoom For Online Teaching: Learn How To Use Zoom For Video Classes, Webinars, Meetings And Video Conferences For Distance And Remote Teaching, M.Dale, 2020, ISBN: 979-8677303692
11. Forcimi i kompetencave te mesidhenies. Kompetencat dixhitale. *Material didaktik i pergatitur ne kuadrin e projektit TECOMP.* <http://www.tecomp.ni.ac.rs/service/2-4-preparing-guidelines-for-the-technological-enhancement-of-teaching-and-learning/>

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS

Studentet jane te detyruar te veprojne ne perputhje me dhe te respektojne ne menyre rigoroze teresine e rregullave, pritshmerive dhe sanksioneve perkatese te parashikuara ne rregulloren e UGJ-se per t'u sjelle me integritet akademik mbeshtetur ne ndershterine.

Studentet jane te detyruar :

- Te mos kopjojne apo japin kopje ne provim
- Te mos kopjojne dhe paraqesin punen e dikujt tjeter
- Te mos fabrikojne apo manipulojne te dhenat
- Te respektojne integritetin dhe dinjtetin njerezor & profesional te personelit akademik dhe atij ndihmes
- Te respektojne integritetin dhe dinjtetin njerezor & profesional te studenteve te tjere

Ne raste shkeljesh te ketyre rregullave studentet penalizohen sic parashikon rregullorja e UGJ-se dhe rregullorja e programit te studimit


Miratoi

Përgjegjësi i Njësisë Bazë/Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës

Dr. Dhori TERPO



PROGRAMI I LËNDËS
GJITHPËRFSHIRJA NË EDUKIM

Titullari/pedagogu i lëndës: Mimoza ÇARKA Doc.dr. 
Ngarkesa: 6 (ECTS), 60 orë mësimore në klasë (2/2), 30 leksione dhe 30 seminare
Viti akademik/semestri kur zhvillohet: 2022-2023, semestri I
Lloji i lëndës: E detyruar
Programi i studimit: "Master profesional" në "Mësuesi në arsimin special"
Adresa elektrnike e titullarit/e pedagogut të lëndës: mcarka2001@yahoo.com

Kodi i etikës: Pedagogu dhe studenti duhet të respektojnë rigorozisht tërësinë e rregullave, pritshmerive dhe sanksioneve përkatëse të parashikuara në rregulloren e UOGJ-së dhe të programit të studimit.

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Lënda: "Gjithëpërfshirja në edukim", është një kurrikul bashkëkohore e cila është në përshtatje me ndryshimet e shoqërisë, ndryshimeve globale dhe të sistemeve arsimore kudo në botë. Kjo lëndë gjatë zhvillimit të saj do të japë tek studentët njohuri mbi metodologjinë për zhvillimin e prespektivës gjithëpërfshirëse si dhe mbi aspektet kulturore dhe metodologjike për promovimin e integritit të fëmijëve me Aftësi të Kufizuar dhe Aftësi Ndryshe në proceset e të nxënit formal dhe jo formal me vëmendje të veçantë tek aktorët e ndryshëm të përfshirë (fëmijët, mësuesit, familja, institucionet arsimore, institucionet social-sanitare dhe educative, burimet që ofron rrethi social). Për gjatë leksioneve të kësaj lënde student do të ballafaqohet me dokumentet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe mënyrës se si ato zbatohen në mënyrë sa më cilësore në kontekste të ndryshme.

Kurrikula gjithëpërfshirëse dhe roli i mësuesit ndihmës në klasat gjithëpërfshirëse.

Me po të njëjtën rëndësi janë jo vetëm mësimdhënia dhe strategjitë gjithëpërfshirëse, po dhe indeksi i gjithëpërfshirjes, i cili bënë të mundur që të analizohet efektivisht se sa shkolla dhe klasat janë gjithëpërfshirëse.

OBJEKTIVAT SPECIFIKE TE LËNDËS:

- Lënda ka si qëllim kryesor edukimin e studentëve me filozofinë e gjithëpërfshirjes.
- Njohjen me dokumentet bazë për të implementuar në mënyrë cilësore gjithëpërfshirjen në klasë
- Lënda u jep studentëve mundësinë që ata të mbajnë një qëndrim kritik ndaj situatave të krijuara dhe të zgjidhin problemet duke iu dhënë shance të barabarta të gjithëve.

- Lënda I pajisë studentët me besimin se ata mund të jenë pjesë shumë e rëndësishme e ndryshimeve në arsimin gjithëpërfshirës.

Në përfundim të studimit të kësaj lënde student:

- Të përshkruajë aspektet kulturore, teorike dhe metodologjike për promovimin e integritit të fëmijëve me aftësi të kufizuar apo me nevoja të vecanta në proceset e të nxënimit formal dhe joformal;
- Të dallojë rolet dhe funksionet e aktorëve të ndryshëm që veprojnë në kontekstet educative dhe joeducative për zhvillimin e proceseve gjithëpërfshirëse;
- Të ndërtojë dhe zbatojnë projekte për jetën duke u bazuar në klasifikimet e publikuara nga OBSH;
- Të zhvillojë marrdhënie ndihmëse dhe ndërhyrje multidisiplinore në mbështetje të prindërve dhe të projekteve për integrimin dhe përfshirjen sociale;
- Të zbatojë projekte educative individuale në bashkëpunim me figurat e tjera profesionale;
- Të identifikojë nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuar, aftësi ndryshe, mjetet dhe teknologjitë ndihmëse për integrimin dhe përfshirjen e këtyre fëmijëve në kontekste të ndryshme sociale;
- Të përdor instrumenta për projektimin, verifikim dhe vlerësimin e ndërhyrjeve e projekteve educative drejtuar fëmijëve me AK dhe AN;

KONCEPTET THEMELORE:

1. aftësi të kufizuar
2. aftësi ndryshe
3. gjithëpërfshirje
4. përfshirje e fëmijëve
5. integritit të fëmijëve
6. identifikoj nevojat
7. ndërhyrje me projekteve educative
8. përfshirje sociale
9. projekte për jetën

TËMAT E LËNDËS:

Tema 1. Prespektivat gjithëpërfshirëse. Fq 3-14

Gjithëpërfshirja në edukim, dikur është menduar si qasje e nevojshme, vetëm për arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta. Gjithëpërfshirja është i gjithë procesi që sigurojnë mësuesit për përfshirjen e gjithë nxënësve të klasës apo shkollës, në veprimtarinë edukative dhe mësimore. Në këtë mënyrë, edhe fëmijët me nevoja të veçanta kalojnë pjesën më të madhe të kohës me fëmijët e tjerë.

Tema 2. Takimi me stereotipet dhe gjykimet. Reziku i të qenit "i huaj" dhe rëndësia e ndërmjetësve formal dhe joformalë. Fq 15-19

Gjithëpërfshirja është i gjithë procesi që sigurojnë mësuesit për përfshirjen e gjithë nxënësve të klasës apo shkollës, në veprimtarinë edukative dhe mësimore. Në këtë mënyrë, edhe fëmijët me nevoja të veçanta kalojnë pjesën më të madhe të kohës me fëmijët e tjerë.

Tema 3. Momentet e përkujdesjs dhe aktivitetet gjatë jetës së përditshme të fëmijëve me aftësi të kufizuar. Fq.20-27

Gjatë analizës së të dhënave, gjithashtu vërejmë një distancë të dukshme të preokupimit të prindërve dhe më tej, të pjesëmarrjes së tyre aktive në shkollë, në lidhje me ide, qasje apo edhe ndihmë konkrete për një gjithëpërfshirje në vendimmarrje.

Tema 4. Vëzhgimi, zbulimi, njohja dhe respektimi me profesionalitet i normalitetit special.Fq 27-32

Gjithëpërfshirja është qasje për të gjithë fëmijët, të cilët në një çast të caktuar të jetës së tyre, apo, për një periudhë të konsiderueshme kohore, mund të shfaqin një nevojë të veçantë fizike, emocionale, sociale, ekonomike.

Tema 5. Përkujdesja, marrdhëeniet ndihmëse dhe aftësitë ripërtëritëse.fq 33-40

Përgjatë kësaj teme studentët do të kalojnë në nivelet e njohjes, aftësimi dhe krijimit të shprehive për elementët e domozdoshëm në arsimin gjithëpërfshirës sic janë: përkujdesja, marrëdh

Tema 6. Njohja dhe projektimi i prespektivës gjithëpërfshirëse. Fq 41-51

Njohja e studentëve me të gjitha mbështetjet kombëtare dhe ndërkombëtare në kuadrin e prespektivës gjithëpërfshirëse. Roli i tyre në këtë perspektivë.

Tema 7. Ndertimi i kontekstit gjithëpërfshirës dhe puna në rrjet.fq 52-55

Ngritja e target grupeve per të përmirësuar të gjitha kontekstet arsimore në kuadër të arsimit gjithëpërfshirës.

Tema 8. Takimi dhe njohja me fëmijën me aftësi në kufizuar në shkollë fq 56-60

Vëzhgime në mjedise për të identifikuar dhe ndihmuar këto institucione.

Tema 9. Praktikrat e mira të integritit të fëmijëve me aftësi të kufizuar në shkollëfq 61-72

Modele nga vende dhe situatë positive ne integrimin e fëmijëve me aftëzi ndryshe.Projektimi, verifikimi dhe vlerësimi i ndërhyrjeve.

Projekteve educative drejtuar fëmijëve me aftësi të kufizuar dhe fëmijëve me aftësi ndryshe. Tekoogjitë e reja për promovimin e gjithëpërfshirjes sociale.fq 73-85

Tema 10. VËSHTIRËSITË DHE SFIDAT E PËRFSHIRJES NË ARSIMIN E

LARTË (2 orë)

Konstruktivizmi si kornizë oaër të kuptuar përfshirjen. Koncepti I “aftësisë së kufizuar” përmes një perspektive historike, sociale, ekonomike dhe arsimore.

Roli I arsimit në reduktimin e përjashtimit social të personave me aftësi të kufizuara.

Si të përshtatet aksesimi për studentët me aftësi të kufizuara në arsimin e lartë?

Tema 11. Ndërtimi i instrumentave veprues.

Identifikimi i materialeve dhe dokumentave funksionale për njohjen e kontekstit kulturor ku bejnë pjesë fëmijët me aftësi të kufizuara. fq 86-95

Tema 12. Plani PEJ (dosje) me anë të këtij dokumenti studentët do të shikojnë në detaje planifikimet individuale të fëmijëve. Student do të aftësohet për të ndërtuar individualisht një plan PEJ.

Tema 13. Marrdheniet ndihmëse dhe proceset multidisiplinare.

Në mbështetje të prindërve për ndërtimin e një projekti për integrimin dhe gjithëpërfshirjen sociale të fëmijëve me aftësi në kufizuar do të shikohen edhe prindërit

si pjesë integrale . Fq 96-107

Tema 14. Indeksi i gjithëpërfshirjes (materialet shtesë) mjeti mates për të skanuar se sa gjithëpërfshirës është çdo institucion edukimi.

Tema 15. Dimensionet e indeksit të gjithëpërfshirjes (material shtesë)

Krijimi I politikës gjithëpërfshirëse. Krijimi i kulturës gjithëpërfshirëse.

Krijimi i praktikave gjithëpërfshirëse.

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE

FREKUENTIMI: Frekuentim i detyruar deri në masën 80% të seancave të seminareve.

KONTROLLI I VAZHUESHËM:

Vlerësim i vazhduar dhe provim final me shkrim në përfundim të lëndës

Provimi final 80%

Vlerësimi i vazhduar 20%

Vlerësimi i vazhduar do të jetë shumatorë e vlerësimit të pedagogut mbi kryerjen e detyrave si më poshtë

- Rezultatet e testeve 5%
- Aktivizimin në seancat e seminareve 5%
- Projekte 10%

Studenti rezulton kalues me minimalisht 45% të vlerësimit total apo 45 pikë.

PROVA FINALE: Provim me shkrim në fund të semestrit

LITERATURA:

a) Literatura bazë e detyrueshme:

Cikël leksionesh: Gjithëpërfshirja në edukim. Prof.asoc.Mimoza Çarka

-Cesaro, A.(2015) *Asilo nido e integrazione del bambino con disabilita*. Carocci: Roma

-Canevaro, A. (2015). *Nascere fragile. Processi educative e pratiche di cura*. EDB: Bologna
-AA.VV. (marzo-aprile, 2014). L'educazione che cura: un processo per fare inclusione, *Infanzia, Focus*, p.91-112. *Spiagiari Edizione* Malaguti, E. (marzo-aprile, 2014). Educazione inclusive: prospettive ecologiche, sociali,umane e processi di resilienza. *Infanzia*, n.2
Malaguti, E. (maggio-giugno, 2013). Pratiche di presa in carico e sfide contemporanee: occasioni di crescita e di cambiamento.

Infanzia, n.3

-Pavone, M.&Farinella, A. (November,2013). Children at birth, children growing up. Integration betëeen healthcare and family education. (marrë nga www.sciencedirect.com)

b) Literatura e rekomanduar:

-Early Childhood Special Education, Vol.25,2005 Ainscoë, M. (1994) *Special Needs in the Classroom*. UNESCO.

-Hegart, S (Ed) (2006) *European Journal of Special Education*. Volume 21, N_o. 2 October. May. Routledge Taylor & Fracis Group.

-Dobrev.ZI-Karadjova. E-Radulov. VI.-/ SPECIALNA PEDAGOGJIKA. Sofia bg. 2002/

-Strategjia Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuar.2005

-Një shkollë për të gjithë. Save the Children, 2013

TeComp: Forcimi I kompetencave të Mësimdhënies, Kompetencat didaktike dhe pedagogjike

Material i përkthyer dhe i përshtatur

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS

Studentët janë të detyruar të veprojnë në përputhje me rregulloren dhe të respektojnë në mënyrë të përpiktë tërësinë e rregullave, pritshmërive dhe sanksioneve përkatëse të parashikuara në rregulloren e UGJ-së për t'u sjellë me integritet akademik mbështetur në ndershmëri.

Studentët janë të detyruar :

- Të mos kopjojnë apo japin kopje në provim
- Të mos kopjojnë dhe paraqesin punën e dikujt tjetër
- Të mos fabrikojnë apo manipulojnë të dhënat
- Të respektojnë integritetin dhe dinjtetin njerëzor & profesional të personelit akademik dhe atij ndihmës
- Të respektojnë integritetin dhe dinjtetin njerëzor dhe profesional të studenteve të tjerë

Në rast shkeljesh të këtyre rregullave, studentët penalizohen siç parashikon rregullorja e UGJ-së dhe rregullorja e programit të studimit.

PËRGJEGJËSI I NJËSISË BAZË TË EMM

Prof. Asoc. Mimoza ÇARKA

PROGRAMI I LËNDËS

ZHVILLIM KURRIKULE

Titullari /pedagogu i lëndës: Mimoza ÇARKA Dr.Doc.

Ngarkesa: 6(ECTS), 60 orë në auditor(2/2); 30 leksione dhe 30 seminare

Viti akademik/semestri kur zhvillohet: 2022-2023, semestri i dytë, viti i parë

Lloji i lëndës: *E detyrueshme*

Programi i studimit: Master në "Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët"

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës: mcarka2001@yahoo.com

Kodi i etikës: Pedagogu dhe studenti duhet të respektojë rigorozisht tërësinë e rregullave , pritshmërive dhe sanksioneve përkatëse të parashikuara në rregulloren UGJ-së dhe të programit të studimit.

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Përmbajtja e lëndës i pajisë studentët me elementët më të rëndësishëm të formimit të mësuesve mbi kurrikulën në përgjithësi dhe kurrikulën me bazë kompetencat. Studentët marrin njohuri rreth zhvillimit të kurrikulës, parimeve, bazave, strukturës dhe tendencave të zhvillimit të saj. Studentët njihen me tema të cilat bëjnë të mundur vlerësimin e kurrikulave dhe të procesit të të mësuarit si dhe trajtimin e bazave të matjes, të vlerësimit në arsim.

Programi i kësaj lënde i aftëson studentët me konceptet që kanë lidhje me bazat psikologjike dhe historike të kurrikulës. Për më tej me modelet përfaqësuese të kurrikulës, burimet, qëllimet, synimet dhe objektivat. Nëpërmjet kësaj lënde hidhet dritë mbi aspektet themelore të kurrikulës, si dhe elementët e kurrikulës.

Në vazhdimësi paraqiten hapat për planifikimin e matjes dhe të vlerësimit. Ky program sjell pranë studentëve kurrikulat shkollore më të përshtatshme, më të vlerësuar si kurrikula bashkëkohore si dhe zbatimin e suksesshëm të tyre në botë. Një vend të veçantë zë korniza kurrikulare në Republikën e Shqipërisë në Arsimin Parauniversitar dhe në detaje Kurrikula Bërthamë e Arsimit të Mesëm të Ulët.

Objektivat e lëndës:

T'u japë mundësi studentëve të thellojnë kuptimin e tyre mbi kurrikulën shkollore shqiptare, duke u fokusuar në punën studimore.

Studentët do të kenë mundësi të njihen me çështjet kryesore teorike mbi kurrikulën dhe do të zhvillojnë strategji për të vlerësuar kurrikulën shkollore, sidomos çështjet që duhet të përballin nxënësit dhe mësuesit kur duhet të punojnë me të.

Në përfundim të programit lëndor studenti duhe të përfitojë aftësi dhe kompetenca:

- ⊙ Të kuptojë në mënyrë vizionare bazat, parimet e ndërtimit të kurrikulës, hartimit të saj nga këndvështrimi psikologjik dhe historik.
- ⊙ Të përdorë dijet e fituara në përmirësimin e kurrikulës dhe planifikimin e mësimin duke vlerësuar elementet bazë dhe zbatimin efektiv të saj.
- ⊙ Të përcaktojë se cilat janë mjetet dhe metodat më bashkëkohore në nevojën e zhvillimit dhe thellimit të kurrikulës.
- ⊙ Të zhvillojë interpretime në lidhje me lëmet e kurrikulës, të shkuara, të sotme dhe të ardhme duke u mbështetur në një grup materialesh .
- ⊙ Të demonstrojë qëndrimin e duhur profesional për çështje konkrete të vlerësimit të kurrikulave dhe të mësimdhënies.
- ⊙ Të zbatojnë cilësisht të mësuarit me bazë kompetencat në kontekstet e reja.
- ⊙ Të përdorë sipas çështjeve literaturën e rekomanduar

KONCEPTET THEMELORE:

1. Zhvillim Kurrikule
2. Parimet, bazat
3. Metodatat teknike
4. Metodatat joteknike
5. Vlerësim kurrikule
6. Kornizë kurrikulare
7. Kurrikulat bërthamë

TEMAT E LËNDËS

TEMA 1: METODAT E KURRIKULËS (2 orë)

Përkufizimi i kurrikulës, Bazat e kurrikulës.

Studentë do të mirë-informohen për përkufizimet bazë të kurrikulës, domethënë, të kuptojnë idetë e rëndësishme, të dobishme, të bukura dhe të fuqishme të specialistëve të fushës. Gjithashtu, nëpërmjet informacioneve të marra studentëve do t'u kërkohet që ata të kenë dëshirën dhe aftësinë për të menduar në mënyrë analitike dhe kritike, për të parashikuar dhe përfytyruar, për të parë lidhjet ndërmjet ideve dhe për të përdorur atë që dinë, në mënyrë që të lartësojnë jetën e tyre dhe të ndihmojnë kulturën e tyre. Fq.1-19

TEMA 2: LËMET E KURRIKULËS (2 orë)

Rolet e punonjësit të kurrikulës. Ndërsa bazat e kurrikulës përfaqësojnë kufijtë e jashtëm të kësaj fushe, lëmet e kurrikulës përshkruajnë kufijtë e brendshëm ose njohuritë e pranuar të kësaj fushe. Këto njohuri mund të nxirren nga studimi i teksteve të botuara. Megjithatë specialistët e kurrikulave përgjithësisht bien dakord në lidhje me bazat, kjo gjë ndodh rrallë në lidhje me atë që përfaqëson lëmet dhe njohuritë e përgjithshme të kurrikulës. Fq.20-29

TEMA 3: METODA TEKNIKO-SHKENCORE (2 orë)

Metoda joteknike e joshkencore. Elemente që duhen marrë parasysh në zhvillimin e kurrikulës
Ideja se një grup metodash është sistematik ose racional përmban rrezikun e nxjerrjes së përfundimit që kampi tjetër është josistematik ose joracional. Megjithatë, përkrahësit e metodave të zhvillimit të kurrikulës që nuk ndodhen në kampin tekniko-shkencor, nuk sugjerojnë prishje të rregullit. Fq.30-57

TEMA 4: PJESËMARRËSIT NË ZHVILLIMIN E KURRIKULËS (2 orë)

Zhvillimi ose hartimi i kurrikulës përfshin një numër të madh njerëzish, si të shkollës ashtu dhe të komunitetit. Ai përfshin edhe nivele të ndryshme planifikimi: nivelin e klasës, nivelin e shkollës, nivelin kombëtar, madje dhe nivelin ndërkombëtar. Ndonjëherë hartuesit punojnë në harmoni me njëri-tjetrin dhe ndonjëherë kanë mosmarrëveshje mes tyre. Fq.58-74

TEMA 5: PJESËT PËRBËRËSE TË HARTIMIT TË KURRIKULËS (2 orë)

Burimet e hartimit të kurrikulës. Hartimi i kurrikulës është mënyra si e konceptojmë kurrikulën dhe si i organizojmë elementet kryesore të saj (lëndën, përmbajtjen, metodat dhe materialet mësimore, përvojat ose veprimtaritë e nxënësit), për të siguruar drejtim dhe orientim gjatë zhvillimit të kurrikulës. Fq. 75-95

TEMA 6: KUADRI KONCEPTUALI KURRIKULËS (2 orë)

Organizimi horizontal dhe organizimi vertikal

Vlerësime mbi disa aspekte të hartimit të kurrikulës. Modelet përfaqësuese të kurrikulës.

Modelet e vlerësimit bihevorist, menaxherial, humanist si dhe modelet e vlerësimit postmodernist. Fq.96-120

TEMA 7: QËLLIMET, SYNIMET DHE OBJEKTIVAT VLERËSIMI (2 orë)

Qëllimet e arsimit; Synimet e arsimit

Objektivat e arsimit, Natyra dhe qëllimi i vlerësimit të kurrikulës;

Përkufizime të vlerësimit. Matja kundrejt vlerësimit; Metodatat e vlerësimit;Metodat shkencore dhe humaniste të vlerësimit. Fq.121-150

TEMA 8: KORNIZA KURRIKULARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (2 orë)

Nevojat për ndryshime kurrikulare. Roli dhe funksioni i Kornizës Kurrikulare, Kompetencat kyçe. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit, Kompetenca e të menduarit, Kompetenca e të mësuarit, Kompetenca për jetë, sipërmarrje dhe mjedis, Kompetenca personale, Kompetenca qytetare, Kompetenca digjitale. Fq. 151-181

TEMA 9: PARIMET E PËRGJITHSHME TË ZHVILLIMIT TË KURRIKULËS (2 orë)

Nivelet e arsimit parauniversitar, Struktura e arsimit parauniversitar. Shkallët e kurrikulës

dhe roli i tyre. Korniza Kurrikulare është e strukturuar në gjashtë shkallë, të cilat paraqesin periodha me karakteristika të përbashkëta për sa i përket zhvillimit të fëmijëve dhe kërkesave të kurrikulës. Ato paraqesin pikën e referimit për caktimin e kompetencave kyçe që duhen zotëruar, kërkesat e progresit të nxënies, organizimin e përvojave të nxënies, qasjen dhe kriteret e vlerësimit, si dhe institucionin përgjegjës për arritjen e tyre. Fq. 182-194

TEMA 10: KURRIKULA BËRTHAMË PËR ARSIMIN E MESËM TË ULËT (2 orë)

Veçoritë e arsimit të mesëm të ulët, Struktura e kurrikulës bërthamë,

Fushat e të nxënit të arsimit të mesëm të ulët dhe arsimin e mesëm të lartë, Plani mësimor.

Dokumenti i kurrikulës bërthamë është dokumenti bazë i cili rregullon ecurinë e procesit mësimor bazuar në Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar të Republikës së Shqipërisë.

TEMA 10: KURRIKULA BËRTHAMË PËR ARSIMIN E MESËM TË ULËT (2orë)

Brenda kurrikulës bërthamë për arsimin e mesëm të ulët, përshkruhen rezultatete të nxënit për çdo kompetence kyçe dhe fushë të nxëni sipas shkallëve të kurrikulës, metodologjitë e zbatimit të kurrikulës, vlerësimi I nxënësve, shpërndarja kohore (plani mësimor) për secilën fushë. Fq. 211-222

TEMA 12: KURRIKULA ME ZGJEDHJE (2 orë)

Udhëzime metodologjike. Organizimi i kurrikulës në kurrikul bërthamë dhe kurrikul me zgjedhje plotëson më mire nevojat e shoqërisë dhe ato të individit dhe siguron shanse të barabarta për të gjithë.

Kurrikula me zgjedhje është pjesë e kurrikulës së përgjithshme e cila, në dallim nga kurrikula bërthamë, zgjidhet nga shkolla dhe zhvillohet brenda kohës së planifikuar në planin mësimor në përputhje me interesat, potencialet, mundësitë, informacionet paraprake të nxënësve dhe me mundësitë e shkollës. Fq. 223-233

TEMA 13: PËRGATITJA E MATERIALEVE MËSIMORE (SHEMBULLI I NJË TEKSTI SHKOLLOR)(2 orë)

Çfarë është një tekst shkollor në shekullin e 21-të? Si e përdorin nxënësit një tekst shkollor? Çfarë nevojitet për një tekst të mire shkollor? Si duket procesi I krijimit të teksteve shkollore?

Si të vlerësoni një tekst shkollor?

TEMA 14: KURRIKULA DHE TEKSTET SHKOLLORE (2 orë)

Student do të përfitojë njohuri se si punohet për hartimin e teksteve shkollore në të gjitha nivelet e shkollimit dhe në të gjitha lëndët. Ata do të përballen me kriteret dhe parimeve bazë

ku mbështeten tekstshkruesit nga këndvështrimi i filozofisë së hartimit dhe ndërtimit të kurrikulave. Po po shumë rëndësi përgjatë këtyre njohurive janë dhe roli i psikologut, sociologut, prindërve, nxënësve në analizimin e nevojave dhe vizionit të sistemit arsimor në këtë botë globale. 244-250

TEMA 15: PËRZGJEDHJA DHE ORGANIZIMI I MËNYRAVE TË MËSIMDHËNIES DHE TË NXËNIT (2 orë)

Do të prezantohen mënyrat dhe teknikat bashkëkohore të procesit të nxënimit si dhe mënyrat efikase të vlerësimit me notë, shprehje apo vlerësime alternative. Mësuesit dhe zhvillimi profesional, kompetencat e fushës dhe situatat e të nxënimit. Mësimdhënia nëpërmjet teknologjive të informacionit dhe shfrytëzimi i platformave dixhitale. Leksion shtesë 12 faqe.

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE

FREKUENTIMI: Frekuentimi i detyruar, jo më pak se 80% të seminareve

KONTROLLI I VAZHDUESHËM:

Vlerësimi i vazhduar 20%:

- Niveli i diskutimit në seminare 5%,
- provime të ndërmjetme 5%,
- detyrë kursi 10%

PROVA FINALE

Provim me shkrim në fund të semestrit 80%

Studenti rezulton kalues me, m inimalisht, 45% të vlerësimit, apo 45 pikë

LITERATURA

a) Literatura bazë e detyruar:

1. *Cikël leksionesh. Zhvillim Kurrikule. Mimoza ÇARKA.*
2. *Kurrikula bazat, parimet dhe problemet. Autorë: Allan C. Orstein, Francis P. Hunkins*
3. *Konceptet themelore për të kuptuar Kurrikulumin”, Marsh, C., J. (2014) CDE. Tiranë.*

b) Literatura e rekomanduar:

1. *Karameta, P. (2014). Arsimi i gjeneratës tjetër. Shtëpia botuese “Sara”, Tiranë.*
2. *Making the curriculum ëork. Botim i “Centre for educational research and innovation”.*
3. *The foundation of Educational Effectiveness, 1997, p.99-138.*
4. *The International Encyclopedia of Educational Evaluation, 1990, p.153-229.*
5. **TeComp: Forcimi I kompetencave të Mësimdhënies, Kompetencat didaktike dhe pedagogjike**
Material i përkthyer dhe i përshtatur

www.mas.gov.al Drejtoria e Kurrikulës
www.izha.edu.al Instituti i Zhvillimit të Arsimit

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS

Studentët janë të detyruar:

- Të veprojnë në përputhje dhe të respektojnë në mënyrë rigorozë tërësinë e rregullave dhe sanksioneve përkatëse të parashikuara në rregulloren e UGJ-së
- Të zbatojnë Kodin e Etikës së Universitetit të Gjirokastrës.
- Të zbatojnë rregulloren e programit të studimit.
- Të mos kopjojnë a japin kopje në provim.
- Të mos kopjojnë e paraesin punën e dikujt tjetër.
- Të respektojnë integritetin e dinjitetin njerëzor e profesional të personelit akademik e atij ndihmës.
- Të respektojnë integritetin e dinjitetin njerëzor e profesional të njeri-tjetrit.

Në rast shkeljesh të këtyre rregullave, studentët penalizohen, sic parashikon rregullorja e UGJ-së dhe rregullorja e Programit të Studimit.

PËRGJEGJËSI I NJËSISË BAZË TË EMM

Prof. Asoc. MIMOZA CARKA

PROGRAMI I LËNDËS

ZHVILLIMI TË NXËNËT DHE MENDIMI KRITIK

Titullari /pedagogu i lëndës: Zhuljeta Lilo Dr. 

Ngarkesa: Kredite: 12 (ECTS), 60 orë mësimore në klasë Leks.:30 Sem.:30 2/2 Semestri I
60 orë mësimore në klasë Leks.:30 Sem.:30 2/2 Semestri II

Viti akademik/semestri kur zhvillohet: 2022-2023, semestri i I & II

Lloji i lëndës: *E detyrueshme*

Programi i studimit: Master në "Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët"

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës: zpcinga@yahoo.com, ilrbozgo@yahoo.com

Kodi i etikës: Pedagogu dhe studenti duhet të respektojë rigorozisht tëresinë e rregullave, pritshmërive dhe sanksioneve përkaese të parashikuara në rregulloren e UGJ-së dhe të programit të studimit.

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Kjo disiplinë krahas shkencave të tjera psikologjike dhe pedagogjike, synon përgatitjen profesionale të studentit, pajisjen e tij me dije të nivelit bashkëkohor në këtë fushë dhe përgatitjen sa më të mirë për jetën si edukator-mësues i brezit të ri, por edhe si këshillues, psikolog dhe prindër të ardhshëm.

Zhvillimi dhe të Nxënët aktualisht shtron probleme që lidhen me procesin e edukimit; maturimi biologjik dhe të nxënët përbëjnë premisat e rritjes, të zhvillimit dhe të përgatitjes së fëmijës për edukimin shkollor dhe në jetë. Përmes këtij moduli studenti njihet me teoricienët më në zë të zhvillimit dhe të nxënët të fëmijës, si: Piaget, Freude, Erikson, Kohlberg, Skinner, Thorndike, Ausubel, Bloom, etj. Do të trajtohen çështje që kanë të bëjnë me zhvillimin e fëmijës në aspektin fizik, kognitiv dhe social, të nxënët, zbatime të teorive të të nxënët në edukim, zgjidhja e problemit, strategji për zhvillimin e të menduarit, motivimin, integrimin e mësimdhënies me të nxënët, stilet e të nxënët, etj. Në këtë modul jepet një informacion i plotë për zhvillimin, të nxënët e fëmijës dheshprehite mendore. Studentëve u jepen njohuri shkencore dhe praktike mbi baza psikologjike rreth të nxënët sipas prirjeve të zhvillimit; studentët do të aftësohen për të zgjidhur problemet e procesit mësimor duke marrë parasysh teorinë e zhvillimit dhe të nxënët, gjykimin e fëmijës, aftësitë e komunikimit të fëmijës, strategjitë dhe teknikat për shprehi të larta mendore, etj.

Realizimi i programit mësimor të këtij moduli synon lidhjen mes teorisë dhe praktikës, ligjëratat teorike do të shoqërohen edhe me shembuj, raste studimore, udhëzime si dhe këshilla praktike nga mësues me përvojë.

OBJEKTIVAT SPECIFIKE TE LËNDËS

Në përfundim të studimit të kësaj lënde studentët janë të aftë të përgjigjen, të mbajnë qëndrime dhe të vlerësojnë pyetjet e mëposhtme:

1. Cfarë është zhvillimi? Përse e studiojmë atë?

2. Cilat janë periudhat e zhvillimit? Cilat janë prirjet kryesore të zhvillimit sipas stadeve.
3. Cfarë është zhvillimi sipas kognitivizmit, psikanalizës, teorive biosociale. Si trajtohet zhvillimi sipas teorive të ndryshme psikologjike? Përse i studiojmë ato?
4. Cfarë kuptojmë me predispozitë genetike dhe aftësi për të nxënë në zhvillimin e qenies njerëzore?
5. Cilat janë teoritë psikologjike të të nxënit? Si gjejnë zbatim në edukim?
6. Përse e studiojmë inteligjencën dhe cili është raporti me zhvillimin e shprehive të larta mendore?
7. Cfarë strategjish dhe teknikash përdorin mësuesit për të rritur shprehitë e të menduarit kritik dhe krijues të nxënësit?

Pas përfundimit të lëndës studentët do të jetë në gjendje të:

- ⊙ Të përgatisë studentin sa më mirë nga ana profesionale, ta pajisë atë me dije dhe shprehi të nivelit bashkëkohor si mësues i ardhshëm.
- ⊙ Të pajisë studentin me dije dhe rekomandime konkrete për ndërtimin e procesit mësimor mbi baza shkencore psiko-pedagogjike. Synimi është që studenti të krijojë një bazë të qëndrueshme psikologjike mbi teoritë psikopedagogjike dhe zbatimin e tyre në procesin mësimor.
- ⊙ Të ruajë një raport të arsyeshëm midis trajtimit bihejviorist dhe atij kognitivist të të nxënit, duke i dhënë më tepër përparësi drejtimit kognitivist.
- ⊙ Studenti të vlerësojë teoritë e të nxënit sipas objektivave të të nxënit duke i vënë theksin teorive kognitiviste dhe konstruktiviste, pasi edhe tendenca e mësimdhënies e kohëve të fundit është zhvillimi i shprehive të të menduarit dhe zgjidhja e problemit.
- ⊙ Studentët të fitojnë shprehitë kryesore të të menduarit kritik
- ⊙ Të dallojnë parimet e të nxënit aktiv dhe të menduarit kritik
- ⊙ Të njihen dhe përvetësojnë metodat dhe modelet e mësimdhënies që nxisin dhe zhvillojnë të menduarit kritik tek nxënësist.
- ⊙ Të aftësohen në përdorimin në procesin mësimor të teknikave të ndryshme që nxisin të menduarit kritik
- ⊙ Studenti të dijë të diskutojë, të hulumtoje dhe të përgatisë detyra kursi për probleme të ndryshme që parashron procesi didaktiko-mësimor.

KONCEPTET THEMELORE:

- Zhvillimi Periudhat e zhvillimit
- Teoritë e zhvillimit
- Zhvillimi kognitiv
- Zhvillimi biosocial
- Zhvillimi sipas teorisë psikanalitike
- Zhvillimi moral
- Të nxënëet bihejviorist
- Të nxënëet social-kognitiv
- Të nxënëet kognitiv

- Konstruktivizmi kognitiv dhe social
- Motivimi
- Inteligjenca dhe të Menduarit
- Shprehitë e të Menduarit dhe Strategjitë e Zgjidhjes së Problemit
- Të menduarit;
- Mendimi kritik;
- Mendimi krijues;
- Strategji dhe teknika;
- Shprehitë e të menduarit;
- Edukimi i të menduarit

TEMAT E LËNDËS

TEMA 1- Zhvillimi

Studentët do të krijojnë një pamje të plotë të përgjithshme në lidhje me zhvillimin e qenies njerëzore përsa i përket periudhave të zhvillimit, parimeve të zhvillimit dhe influencave genetike dhe mjedisore të zhvillimit.

Çështjet:

Kuptimi i përgjithshëm mbi zhvillimin njerëzor. Konteksti shoqëror i zhvillimit sipas Bronferbrenner. Parimet e përgjithshme të zhvillimit. Influencat mbi zhvillimin.

Literatura: Zhuljeta Lilo; *Cikël leksionesh: Faqe (1-8)*

Theodhori Karaj Psikologji e zhvillimit të fëmijës, f.1-11, Tiranë 2004

Liljana Reçka, Psikologji e zhvillimit të fëmijës, f. 3-21, Tiranë 2005

TEMA 2- Fëmijëria. Zhvillimi fizik, motor, fiziologjik dhe shëndeti

Studentët do të njihen me karakteristikat e zhvillimit fizik, motor, fiziologjik përgjatë periudhave të zhvillimit.

Çështjet:

Proceset dhe Periudhat e Zhvillimit. Rritja në fëmijëri: Fëmijëria e Parë, Fëmijëria e Dytë dhe Fëmijëria e Mesme. Zhvillimi fizik, motor, fiziologjik. Shëndeti i fëmijës dhe edukimi.

Literatura: Zhuljeta Lilo; *Cikël leksionesh: Faqe (8-13)*

Theodhori Karaj Psikologji e zhvillimit të fëmijës, Tiranë 2004

Liljana Reçka, Psikologji e zhvillimit të fëmijës, Tiranë 2005. f.33-60, 73-76, 90-100, 135-40

TEMA 3-Zhvillimi kognitiv

Studentët do të njihen, kuptojnë dhe vlerësojnë zhvillimin njerëzor sipas këndvështrimit kognitivist. Predispozitat genetike të trurit, mjedisi, kultura dhe gjuha janë faktorët e zhvillimit mendor të njeriut.

Çështjet:

Zhvillimi i trurit dhe zhvillimi kognitiv. Teoria e Piazhës për zhvillimin kognitiv. Ndikimet në zhvillimin e të menduarit.

Disa kufizime të teorisë së Piaget. a) problemi me fazat. b) nënvlerësimi i aftësive të fëmijëve. c) zhvillimi kognitiv dhe kultura. Katër fazat e zhvillimit kognitiv. Faza sensorimotore, preoperative, operacionale konkrete, operacionale abstrakte.

Burimet sociokulturale të mendimit individual. Mjetet kulturore dhe zhvillimi kognitiv. Zona e zhvillimit proksimal.

Kufizimet e teorisë së Vigotskyt.

Mjedisi, kultura dhe zhvillimi gjuhësor. Disa teori mbi përvetësimin e gjuhës bihevoriste, nativiste, kognitiviste. Periudhat e zhvillimit gjuhësor të fëmijës.

Literatura: Zhuljeta Lilo; *Cikël leksionesh: Faqe (14-36)*

Theodhori Karaj Psikologji e zhvillimit të fëmijës, f.264-266, 299-305, Tiranë 2004

Liljana Reçka, Psikologji e zhvillimit të fëmijës, f.107-135, Tiranë 2005

TEMA 4- Zhvillimi afektiv

Studentët do të njihen, kuptojnë dhe vlerësojnë zhvillimin njerëzor sipas këndvështrimit psikanalitik.

Çështjet:

Teoria e Frojdit për zhvillimin afektiv të fëmijës.

Stadet e zhvillimit psikoseksual.

Jeta afektive e fëmijërisë së mesme.

Literatura: Zhuljeta Lilo; *Cikël leksionesh: Faqe (36-42)*

Theodhori Karaj Psikologji e zhvillimit të fëmijës, f.1-11, Tiranë 2004

Liljana Reçka, Psikologji e zhvillimit të fëmijës, f.83-90, 149-150, Tiranë 2005

TEMA 5- Zhvillimi vetjak, shoqëror dhe moral

Njeriu është qenie sociale, dhe si e tillë njohja e botës vjen përmes njohjeve të vetes, njohjes së tjetrit dhe respektit moral. Në këtë kontekst do të trajtohen teoricienët e zhvillimit biosocial dhe moral të individit.

Çështjet:

Koncepti dhe vlerësimi për veten dhe të tjerët. Zhvillimi gjinor. Identiteti gjinor, rolet gjinore.

Marrëdhëniet me moshatarët. Fazat e zhvillimit bio-social sipas Eriksonit.

Diversiteti dhe konvergjencat në zhvillimin personal/shoqëror. Të kuptuarit e tjetrit dhe zhvillimi moral.

Teoria e mendjes dhe qëllimet. Gjykimet morale, konvencionet shoqërore dhe zgjedhjet personale.

Teoricienët kognitive të interpretimit të gjykimit moral. Fazat e zhvillimit moral sipas Kohlberg,

Piaget, Canestrari. Toritë psikanalitike dhe të të nxënies social në zhvillimit moral. F.

Literatura: Zhuljeta Lilo; *Cikël leksionesh: Faqe (42-70)*

Theodhori Karaj Psikologji e zhvillimit të fëmijës, 299-303, Tiranë 2004

Liljana Reçka, Psikologji e zhvillimit të fëmijës, f. 153-215, Tiranë 2005

TEMA 6- Adoleshenca

Në periudhën e adoleshencës ndodhin ndryshime të mëdha në të gjitha aspektet e zhvillimit dhe konsolidimi i tyre. Studentët do të kuptojnë, krahasojnë dhe vlerësojnë ndryshimet zhvillimore të kësaj periudhe moshore me periudhat e mëparshme të zhvillimit.

Çështjet:

Zhvillimi fizik dhe fiziologjik. Pasojat e kalimit të pubertetit herët ose vonë. Ndryshimet kognitive në adoleshencë. Audiencia imagjinare dhe miti personal.

Eriksoni mbi zhvillimin biosocial të adoleshentit. Ndikimet në procesin e formimit të identitetit.

Variantet e identitetit sipas Eriksonit dhe Marcias. Formimi i identitetit tek adoleshenti. Marrëdhëniet me moshatarët dhe prindërit.

Literatura: Zhuljeta Lilo; *Cikël leksionesh: Faqe (70-78)*

Theodhori Karaj Psikologji e zhvillimit të fëmijës, f.308-316, Tiranë 2004

Liljana Reçka, Psikologji e zhvillimit të fëmijës, f. 227-252, Tiranë 2005

TEMA 8 -Të nxënëti biheviolist

Zhvillimi është rrjedhojë e predispozitave genetike të individit dhe e aftësisë së tij për të nxënëti. Do të trajtohet të nxënëti sipas kënvështrimit biheviolist dhe zbatimi i tij në edukim.

Çështjet:

Të nxënëti. Kuptim i përgjithshëm. Drejtimet psikologjike në të nxënëti.

Të nxenet biheviolist. Kushtëzimi klasik. Parimet themelore. Zbatime ne edukim.

Kushtëzimi veprues, tiparet themelore. Përforcimi, programet themelore, llojet e përforcimit. Ndëshkimi, faktorët që ndikojnë në efektivitetin e tij. Analiza e sjelljes së zbatuar në edukim. Rritja e sjelljes së dëshirueshme. Vlerësimi i kushtëzimit veprues dhe analiza e sjelljes së zbatua

Literatura: Zhuljeta Lilo; *Cikël leksionesh: Faqe (79-88)*

Anita Woolfolk Psikologji Edukimi, f. 198-212, Tiranë 2011

TEMA 9-Të nxënëti kognitiv

Studimet për zhvillimin e aftësisë komplekse njerëzore, revolucionin kompiuterik dhe zbulimet e thella në kuptimin e proceseve të zhvillimit të gjuhës, kontribuan në ringjalljen e studimeve kognitive.

Pikëpamja kognitive e të nxënëti studion proceset mendore të të nxënëti në mënyrë shkencore dhe pranon se njerëzit janë pjesëmarrës aktivë në të kuptuarit e botës.

Çështjet:

Lindja e Psikologjisë Kognitive. Ndikimi i geshtaltëve. Instajti dhe hartat cognitive.

Disa zhvillime kryesore të të nxënëti kognitiv. Të nxënëti e kuptimshëm. Kontributi i Brunerit. Truri dhe të menduarit. Roli i perceptimit, i kujtesës dhe metakognitivizmi. Përpunimi i informacionit dhe mësimdhënia. Roli i perceptimit, i kujtesës (fiksimi, ruajtja, riprodhimi, harresa) në përpunimin e informacionit. Të menduarit: formimi i koncepteve, arsyetimi. Të menduarit kritik. Mësimdhënia për transfer. Tipet e transferës .

Literatura: Zhuljeta Lilo; *Cikël leksionesh: Faqe (89—102)*

Anita Woolfolk Psikologji Edukimi, f. 234-243, Tiranë 2011

Literatura: Zhuljeta Lilo; *Cikël leksionesh: Faqe (89—102)*
Anita Woolfolk Psikologji Edukimi, f. 234-243, Tiranë 2011

TEMA 10- Teoria social cognitive e të nxënës

Teoria e Bandurës e të nxënës social-kognitiv shkoi përtej bihaviorizmit, përshkruan mangësitë e bihaviorizmit dhe nevojën e të shikuarit të njerëzve në kontekstin shoqëror. Kjo teori është shpjegim madhor për aftësitë shoqërore, kognitive dhe të sjelljes së njerëzve, të aftë për përshtatje në mjedisin që i rrethon.

Çështjet:

Të nxënës vëzhgues në mësimdhënie. Teoria e sjelljes cognitive dhe e vetërregullimit. Vetefikasiteti. Sensi i efikasitetit të mësuesit

Literatura: Zhuljeta Lilo; *Cikël leksionesh: Faqe (102-106)*
Anita Woolfolk, Psikologji Edukimi, 348-356, Tiranë 2011

TEMA 11-Konstruktivizmi kognitiv dhe social

Qasja Konstruktive është një qasje relativisht e re ndaj procesit të njohjes dhe të mësuarit. Mund të konsiderohet si qasja kryesore teorike në arsim dhe themel i shumë sistemeve moderne arsimore. Avantazhi i konstruktivizmit është fokusimi në ndërtimin kuptimplotë, bashkëpunues dhe të bazuar në përvojë të njohurive dhe vlera e tij për mësimin është domethënëse, si për mësimdhënësit dhe për nxënësit, është qasja e cila orienton më së miri në të menduarit aktiv dhe në zhvillimin e vazhdueshëm të aftësive. Këndvështrimet konstruktiviste rreth të nxënës mbështeten në dy ide qendrore: Nxënësit janë aktivë në ndërtimin e njohurive të tyre dhe së dyti Në këtë proces të ndërtimit të njohurive, kanë rëndësi ndërveprimet sociale.

Çështjet:

Pikëpamjet konstruktive në të nxënës. Konstruktivizmi si koncept filozofik, psikologjik dhe pedagogjik.

Konstruktivizmi si paradigmat e edukimit. Konstruktivizmi kognitiv/psikologjik/individual.

Konstruktivizmi social i Vigotskit. Të kuptojmë procesin e ndërtimit të njohurive. Pronësia e nxënësit në të nxënës.

Marëdhënia midis studentëve dhe mësuesve të Universitetit në mësimin universitar në formë konstruktiviste. Rolet dhe pozicioni i mësuesve dhe nxënësve. Vlerësimi në mësimdhënie me orientim konstruktivist.

Literatura: Zhuljeta Lilo; *Cikël leksionesh: Faqe (107-112)*
Anita Woolfolk Psikologji Edukimi, f.310-316, Tiranë 2011

TEMA 12-Inteligjenca dhe të menduarit

Të nxënës në edukim sytë drejt rritjes së aftësive mendore drejt niveleve më të larta, ato të zgjidhjes së problemit. Teorinë e inteligjencës dhe të zgjidhjes së problemit ofrojnë teori dhe strategji që nxitin proceset e larta mendore.

Çështjet:

Inteligjenca dhe të menduarit. Teoritë rreth inteligjencës. Modeli Sternberg, Gardneri dhe inteligjencat e shumëfishta. Struktura e të menduarit, Perkinz.

Literatura: Zhuljeta Lilo; *Cikël leksionesh: Faqe (113-133)*

TEMA 13 Motivimi

Studentët do të njihen dhe përvetësojnë teorinë rreth motivimit. Synimi i motivimit duhet të jetë nxitja drejt Motivimit të brendshëm për sukses.

Çështjet:

Pikëpamjet bihevisoriste dhe kognitiviste të motivimit. Ndikimet e motivimit në të nxënë. Motivimi dhe të nxënë në shkollë. Modeli target. Detyra në funksion të suksesit.

Mbështetja e autonomisë dhe njohja publikisht e suksesit. Grupimi, vlerësimi dhe koha.

Diversiteti dhe konvergencat në motivim.

Strategjitë për nxitjen e motivimit.

Literatura: Zhuljeta Lilo; *Cikël leksionesh: Faqe (134-144)*

Anita Woolfolk, Psikologji Edukimi, 376-383, Tiranë 2011

TEMA 14: Kuptimi mbi të menduarit dhe karakteristikat e tij. (2 orë)

Të menduarit përfshin si aspekte kritike ashtu edhe ato krijuese të mendjes, pra si përdorimin e arsyes ashtu edhe gjenerimin e ideve.

Çështjet:

Çfarë është të menduarit dhe cilat janë cilësitë kryesore të të menduarit.

Përdorimi i arsyes dhe gjenerimi i ideve.

Literatura: *Cikël Leksionesh; Ilir Bozgo, fq.1-6*

B.Musai " Psikologjia e Edukimit " Tiranë 2001. fq. 3-12

TEMA 15: Kategoritë bazë të të menduarit logjik.(2 orë)

Kategoritë e të menduarit kritik si: Koncepti, gjykimi, arsyetimi. Një nga karakteristikat bazë të të menduarit është të operuarit me simbole. Simbolet më të shpeshta janë konceptet. Konceptet dhe të menduarit janë të lidhura në mënyrë reciproke.

Çështjet:

Kategoritë e të menduarit kritik: Koncepti, gjykimi, arsyetimi

Të operuarit me simbole, konceptet

Literatura: *Cikël Leksionesh; Ilir Bozgo, fq.7-14*

B.Musai " Psikologjia e Edukimit " Tiranë 2001. fq. 13-20

TEMA 16: Kuptimi i përgjithshëm për të menduarit kritik.(2 orë)

Nga vinë njohuritë për të menduarin kritik, lidhjet që mendimi kritik ka me shkencat e tjera. Formimi i koncepteve është mjaft i ndërlikuar dhe në këtë mënyrë formimi, marrin pjesë veprime të shumta mendore si: krahasimi i objekteve, diferencimi i tyre, analiza, sinteza.

Çështjet:

Lidhjet që mendimi kritik ka me shkencat e tjera
Krahasimi i objekteve, diferencimi i tyre, analiza, sinteza

Literatura: *Cikel Leksionesh*; Ilir Bozgo, fq.15-20
B.Musai "Psikologjia e Edukimit" Tiranë 2001. fq. 21-29

TEMA 17: Historik i shkurtër i lëvizjes për të menduarit kritik dhe rëndësia e tij .(2 orë)
Si ka lindur të menduarit kritik, historiku i lindjes dhe zhvillimi i të menduarit kritik. Studiuesit që kanë ndjekur lëvizjen në zhvillim të trajtimit të problematikës së të menduarit kritik, kanë vënë re një evolucion si në teorinë, ashtu edhe në zbatimin në praktikë të mënyrave që nxisin të menduarit kritik.

Çështjet:

Historiku i lindjes dhe zhvillimi i të menduarit kritik
Evolucion në teorinë dhe në zbatimin e të menduarit kritik

Literatura: *Cikel Leksionesh*; Ilir Bozgo, fq.20-25
B.Musai "Psikologjia e Edukimit" Tiranë 2001. fq. 30-40

TEMA18: Të menduarit kritik si qëllim i arsimit.(2 orë)
Sa i rëndësishëm është të menduarit kritik në arsim, si lidhet të menduarit kritik me arsimin. Cilat shprehje të të mësuarit duhet t'u mësojmë fëmijëve? Si t'ua mësojmë atyre këto shprehje?

Çështjet:

Rëndësia e të menduarit kritik në arsim
Lidhja e të menduarit kritik me arsimin
Shprehjet e të mësuarit të mendimit kritik.

Literatura: *Cikel Leksionesh*; Ilir Bozgo, fq.25-29
B.Musai "Psikologjia e Edukimit" Tiranë 2001. fq. 41-60

TEMA 19: Strategji dhe teknika që zhvillojnë MK të nxënësve në procesin mësimor. (2 orë)
Disa nga strategjitë dhe teknikat që mund të përdoren në procesin mësimor, metodat më efektive, sa ndihmojnë këto teknika për një arsim cilësor. Domosdoshmëria e përdorimit të metodave që nxisin të mësuarit kritik në procesin mësimor.

Çështjet:

Disa nga strategjitë dhe teknikat për nxitjen e mendimit kritik.
Efikasiteti i përdorimit të teknikave dhe strategjive.

Literatura: *Cikel Leksionesh*; Ilir Bozgo, fq.25-41
B.Musai "Psikologjia e Edukimit" Tiranë 2001. fq. 60-69

TEMA 20 : Pyetjet si mjet për nxitjen e MK.(2 orë)
Të menduarit është i drejtuar nga pyetjet. Pyetjet e fëmijëve, të nxënësve, të mësuesve. Heshtja e mësuesit

pas pyetjes si moment nxitës për nxënësin. Të cilit tip duhet të jenë pyetjet që vënë në lëvizje të menduarit e fëmijëve?

Çështjet:

Të menduarit e nxitur nga pyetjet.
Llojet e pyetjeve për nxitjen e të menduarit.
Taktikat e përdorura nga mësuesi.

Literatura: *Cikel Leksionesh*; Ilir Bozgo, fq.41-46
B.Musai "Psikologjia e Edukimit" Tiranë 2001. fq. 70-90

TEMA 21: Taxonomia e Bloom-it dhe MK.(2 orë)

Çfarë është taksonomia e Bloom-it, si përdoret kjo teknikë në procesin mësimor. Termi taksonomi ka disa kuptime si psh: hartë e objektivave në edukim, mënyrë grupimi e objekteve të zgjedhura, klasifikim të dhënash sipas parimeve që përcaktojnë ndarjen e tyre në bazë të raporteve të tyre natyrore.

Çështjet:

Kuptimi dhe kriteret e taksonomisë
Taxonomia e Bloomit në procesin mësimor.

Literatura: *Cikel Leksionesh*; Ilir Bozgo, fq.46-50
B.Musai "Psikologjia e Edukimit" Tiranë 2001. fq. 90-105

TEMA 22: Shprehitë e të menduarit logjik dhe zhvillimi i tyre në mësim. (2 orë)

Disa shprehitë të cilat janë efikase në përdorimin e analizës, kërkesat që duhen plotësuar për të kryer një analizë.

Çështjet:

Analiza si pjesë e tërë procesit mësimor.
Disa shprehitë efikase në përdorimin e analizës.
Literatura: *Cikel Leksionesh*; Ilir Bozgo, fq.50-57

B.Musai "Psikologjia e Edukimit" Tiranë 2001. fq. 105-125

TEMA 23: Të menduarit krijues dhe krijimtaria njerëzore. (2 orë)

Koncepte për të menduarit kritik, ndikimi i shkencave të ndryshme në të menduarit krijues. Të menduarit krijues është një nga llojet e të menduarit i cili është komponent i rëndësishëm i aftësive krijuese të individit.

Çështjet:

Koncepte për të menduarit kritik
Të menduarit krijues

Literatura: *Cikel Leksionesh*; Valbona Caushi, fq.57-62
B.Musai "Psikologjia e Edukimit" Tiranë 2001. fq. 125-134

TEMA 24: Aspektet dhe bazat e krijimtarisë. Edukimi i të menduarit dhe aktiviteti krijues tek

TEMA 24: Aspektet dhe bazat e krijimtarisë. Edukimi i të menduarit dhe aktiviteti krijues tek nxënësi (2 orë)

Të menduarit kritik dhe krijues, koncepte për të menduarit krijues dhe krijimtarinë. Krijimtaria presupozon ekzistencën e disa dukurive psikologjike të personalitetit të njeriut, te aftësive, njohurive, shprehive, motiveve. Një rëndësi të veçantë merr përdorimi i aparatit pedagogjik të teksteve mësimore si faktor i rëndësishëm për nxitjen e mendimit krijues për nxënësin. Një vëzhgim i aparatit pedagogjik në disa tekste mësimore apo krijues të të gjithë nxënësve.

Kuptimi mbi mendimin kritik krijues dhe krijimtarinë

Dukuri psikologjike të personalitetit dhe krijimtaria

Diagnostifikimi i aftësive krijuese

Rrugët e zhvillimit të tyre në procesin mësimor

Literatura: *Cikel Lektonesh; Ilir Bozgo, f.63-71 fq.88-94*

B.Musai "Psikologjia e Edukimit" Tiranë 2001. fq. 174-1

B.Musai "Psikologjia e Edukimit" Tiranë 2001. fq. 134-160

B.Musai "Psikologjia e Edukimit" Tiranë 2001. fq. 160-173

TEMA 25: Rëndësia e të menduarit kritik dhe krijues në procesin mësimor (2 orë)

Rëndësia e të menduarit kritik. Rëndësia e të menduarit krijues. Lidhja e të dy proceseve të të menduarit, dhe rëndësia e tyre në kurrikulat e arsimit.

Çështjet:

Rëndësia e të menduarit kritik dhe krijues.

Rëndësia e tyre në kurrikulat e arsimit.

Literatura: *Cikel Lektonesh; Ilir Bozgo, fq.95-113*

TEMA 26: Teknika për të nxitur mësimdhënien dhe të mësuarit interaktiv me kuptueshmëri

Një domosdoshmëri e arsimit të lartë bashkëkohor është mundësia e studentëve për të mësuar në mënyrë të pavarur. Tu kërkojë studentëve të të kujtojnë, të shpjegojnë, të analizojnë, të zbatojnë dhe të vlerësojnë njohuritë ekzistuese në vend të ritregimit të thjeshtë të asaj që lexojnë, është një arritje që kërkon përpjekje nga ana e lektorëve për të ndryshura mënyrën se si ata përdorin kohën e vlefshme, por të kufizuar të leksioneve. Sesione që zgjasin 5 deri në 10 minuta të leksioneve tradicionale mund të përdoren për të ndërlidhur aktivitetet e njëpasnjëshme në orën e mësimit dhe për të ofruar shpjegime shitesë dhe përmbledhje të temave dhe koncepteve të ndërlidhura. Kjo ndihmon studentët të kultivojnë aftësitë e larta të të menduarit dhe të lehtësojnë kalimin e tyre nga të qenët fillestar drejt të bërit eksperti në fushat e tyre të interesit.

Cështjet:

Përvetësimi i njohurive bëri nga studentët përpara orës së mësimit.

Aktivite të ndërveprimi aktiv tue materialiv. Pyetje të hapura në kartela treguese të panën shkrua

Pyetje me alternativa

Hartat konceptuale dhe grafikët Krahaso dhe dallo Transferimi i të mësuarit dhe njohja e modeleve

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE-

FREKUENTIMI: Frekuentimi detyruar deri në masën 80% të seancave të seminareve.

KONTROLLI I VAZHUESHËM:

Vlerësim i vazhduar dhe provim final me shkrim në përfundim të lëndës.

Provimi final 75%

Vlerësimi i vazhduar 25%

Vlerësimi i vazhduar të jetë shumatore e vlerësimit të pedagogut mbi kryerjen e detyrave si më poshtë

- Rezultatet e testeve 15%
- Aktivizimin në seancat e seminareve 10%

Studenti rezulton kalues me minimalisht 45% të vlerësimit total apo 45 pikë.

PROVA FINALE: Provim me shkrim në fund të semestrit.

LITERATURA

a) Literatura bazë e detyruar:

Psikologjia e zhvillimit. Recka L., Shtëpia botuese e librit universitar, Tiranë 2005.

Psikologji e zhvillimit, Th.Karaj, Progres, Tiranë 2004

Anita Woolfolk Psikologji Edukimi, Tiranë 2011

B.Musai, Psikologji edukimi, Tiranë 1999

Botim i AEDP, Studio gjithshka, arsyes vendin e parë, (Përmbledhje artikujsh për mendimin kritik) Tiranë, 1998

L.Vaughn, C. MacDonald, Fuqia e mësimit kritik, CDE Tiranë, 2010

b) Literatura shtesë:

Psikologjia, Charles G. Morris, Albert A. Maisto, CDE, 2008.

Psikologjia e zhvillimit. Parasqevopoullou, Athinë 1985.

Psikologji pedagogjike. Axil.g.Kapsali, Adelfon Kyriakidhi, Athinë 2003

Zhvillimi i shprehive të të menduarit në shkollë, CDE Tiranë 2005

Grup autorësh, Mësimdhënia me në qendër nxënësin, Tiranë 2005

Materiale të Projektit, Zhvillimi i të menduarit kritik në lexim/shkrim

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS

Studentët janë të detyruar të veprojnë në përputhje me dhe të respektojnë në menyrë rigorozë tëresinë

e rregullave, pritshmërive dhe sanksioneve përkatëse të parashikuara në rregulloren e UGJ-së për t'u sjellë me integritet akademik mbështetur në ndershmërinë.

Studentët janë të detyruar :

- Të mos kopjojnë apo japin kopje në provim.
- Të mos kopjojnë dhe paraqesin punën e dikujt tjetër.
- Të mos fabrikojnë apo manipulojnë të dhënat.
- Të respektojnë integritetin dhe dinjtetin njëzëz & profesional të personelit akademik dhe atij ndihmës.
- Të respektojnë integritetin dhe dinjtetin njëzëz & profesional të studentëve të tjerë

Në raste shkeljesh të këtyre rregullave studentët penalizohen siç parashikon rregullorja e UGJ-së dhe rregullorja e programit të studimit.

Prof. asoc. Mimona Çarha



PROGRAMI I LËNDËS
PSIKOLOGJI SHKOLLORE

Titullari /pedagogu i lëndës: Zhuljeta Lilo Dr. 

Ngarkesa: Kredite: 6 (ECTS), 60 orë mësimore në klasë (2/3) Leks 24; Sem:36

Viti akademik/semestri kur zhvillohet: 2020-2021, semestri II

Lloji i lëndës: Me zgjedhje

Programi i studimit: Master Profesional në “Mësuesi për Arsimin Fillor”

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës: zpcinga@yahoo.com

Kodi i etikës: Pedagogu dhe studenti duhet të respektojë rigorozisht tëresinë e rregullave, pritshmërive dhe sanksioneve përkatëse të parashikuara në rregulloren e UGJ-së dhe të programit të studimit.

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Ky program mësimor synon të ofrojë njohuri dhe trajnim profesional të studentëve për aplikimin e teorive, dijeve, aftësive dhe kompetencave psikologjike në sistemin shkollor. Programi i studimit është ndërtuar në mënyrë që të formojë psikologë shkollorë, të cilët të jenë të aftë të ofrojnë shërbimet më të përshtatshme për komunitetin e shkollës. Qëllimi kryesor i punës së specialistit të shërbimit psikologjik në shkollë fokusohet në promovimin dhe zhvillimin mendor e fizik të nxënësve si dhe në ndihmesën e mbështetjen që jep për rritjen e cilësisë së procesit të mësimnxënies dhe mësimdhënies. Studentët do të njihen me detyrat dhe shërbimet që ofron specialisti i shërbimit psikologjik në shkollë. Studentët duhet të kuptojnë se psikologu shkollor i realizon shërbimet pas një bashkëpunimi me personelin administrativ dhe pedagogjik për konceptimin dhe realizimin e shërbimeve që lidhen me vlerësimin e rezultateve të nxënësve, me orientimin e karrierës dhe me zhvillimin social dhe personal të nxënësve.

OBJEKTIVAT SPECIFIKE TE LËNDËS:

Në përfundim të kësaj lënde, studentët duhet të jenë të aftë:

- Të njohin dhe përvetësojnë objektin e studimit të psikologjisë shkollore, teorinë, njohuritë dhe kompetencat që duhet të zotërojnë psikologu shkollor.
- Të njohin dhe përvetësojnë detyrat, përgjegjësitë dhe studimet e psikologut shkollor.
- Të njohin dhe përvetësojnë detyrat, përgjegjësitë dhe studimet e psikologut shkollor.
- Të dallojnë detyrat, përgjegjësitë dhe studimet e psikologut dhe këshilluesit shkollor.
- Të zbatojnë njohuritë dhe aftësitë gjatë kryerjes së detyrave të kursit/studime rasti dhe praktikës profesionale.

KONCEPTET THEMELORE:

- Psikologji shkollore
- Psikologu shkollor
- Këshilluesi shkollor
- Shërbimet e psikologut shkollor
- Drejtimet e punës së psikologut shkollor
- Këshillim
- Vlerësim
- Bashkëpunim
- Konsultim
- Referim
- Instrumentet e punës së psikologut shkollor

TEMAT E LËNDËS

Tema 1 Përkufizimet e hershme të Psikologjisë shkollore.

Objekti i studimit, historiku i studimit të Psikologjisë Shkollore.

Baza ligjore për shërbimin psikologjik shkollor.

Cikël leksionesh fq.1-9

Tema 2 Shërbimet bazë të punës së Psikologut shkollor. Drejtimet kryesore të punës së psikologut shkollor. Psikologu shkollor dhe këshilluesi shkollor.

Edukimi profesional dhe të ushtruarit e profesionit.

Cikël leksionesh fq.10-23

Tema 3 Komunikimi i efektshëm pedagogjik në arsimin e lartë.

Cilat janë vecoritë dhe funksionet e komunikimit pedagogjik. Cilat lloje të komunikimit janë të efektshme. Si mund të krijojmë një komunikim të efektshëm. Si mund të zgjedhim konfliktet në mënyrë konstruktive.

Literatura: Moduli: Forcimi i kompetencave të mësimit dhe mësimdhënies. Kompetencat didaktike dhe pedagogjike. Te Comp faqe: 80-103

Tema 4 Kushtet e lindjes dhe zhvillimit të drejtimeve kryesore të punës së psikologut shkollor.

Përballja me sfidat e nxënësve dhe çrregullimet e rritjes. Shërbimi psikologjik në shkollë si kusht i nevojshëm dhe i domosdoshëm. Kushtet e lindjes dhe zhvillimit të shërbimeve të psikologut shkollor.

Cikël leksionesh fq.23-32

Tema 5 Modele studimore të Psikologjisë Shkollore për detyrat dhe rolet e psikologut shkollor.

Modeli tradicional, modeli problemzgjidhës, metodat alternative mbështetur në të dhënat.

Cikël leksionesh fq.32-45

Tema 6 Ndërhyrjet parandaluese për sjellje pozitive.

NSP përdoret për të nxitur sjelljen pozitive në shkollë. Përmes zbatimit të NSP-ve, përmes lëndëve dhe veprimtarive shkollore, nxënësit mësojnë rreth sjelljes dhe qëndrimeve pozitive, ashtu siç mësojnë dhe përmbajtjen kurrikulare.

NSP zbatohet në nivel shkolle, klase dhe individi. Qëllimet e zbatimit dhe mënyrat e aplikimit.

Cikël leksionesh fq. 45-55

Tema 7. Zbatime të Sistemit për Ndërhyrje pozitive

Strategjitë e zbatimit të NSP në nivel shkolle, grupi dhe individi.

Ekipi i trajnimit, funksioni dhe detyrat.

Modeli i trajtimit të një problemi mbështetur në të dhëna gjatë aplikimit të NSP.

Zbatimi i praktikave pozitive dhe proaktive.

Cikël leksionesh fq.55-64

Tema 8. Sistemi i Prandalimit të hershëm për fëmijët në rrezik të braktisjes së shkollës Cfarë është SPH. Identifikimi i fëmijëve me rrezik braktisje. Zbatimi i SPH. Bashkëpunimi ndërmjet palëve

Cikël leksionesh fq.64 -74

Tema 9. Bullizmi, modelet e interpretimit, strategjitë e ndërhyrjes, roli i Psikologut shkollor.

Identifikohet profili i fëmijës bullist, i fëmijës viktimë, si dhe rolet sipas modeleve interpretuese. Roli dhe qëndrimi i mësuesit, bashkëmoshatarëve dhe i psikologut shkollor. Strategjitë ndërhyrëse në shkollë. Roli ndihmës i psikologut shkollor dhe pengesat në menaxhimin e rolit. Profili i bullistit dhe i fëmijës së bulluar. Strategji menaxhimi dhe efekte të deshtimit në menaxhimin e bullizmit

Cikël leksionesh fq.74-85

Tema10. Fëmijët me rrezik braktisje të shkollës.

Ndërhyrje dhe reagime nga psikologu shkollor në bashkëpunim me këshilin e mësuesve dhe të prindërve.

Cikël leksionesh fq.85-91

Tema 11. Vlerësimi i shërbimeve të Psikologut shkollor, vetëvlerësimi dhe vlerësimi i jashtëm.

Janë përcaktuar fushat kryesore të shërbimeve të psikologut shkollor si dhe vlerësimi i këtyre

shërbimeve

Cikël leksionesh fq.91-98

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE

FREKUENTIMI: Frekuentim i detyruar deri në masën 75% të seancave të seminareve.

KONTROLLI I VAZHDUESHËM:

Vlerësim i vazhduar dhe provim final me shkrim në përfundim të lëndës.

Provimi final: **75%**

Vlerësimi i vazhduar: **25%**

Vlerësimi i vazhduar do të jetë shumatore e vlerësimit të pedagogut mbi kryerjen e detyrave si më poshtë:

- Rezultatet e testeve 15%
- Aktivizimin në seancat e seminareve 10%

Studenti rezulton kalues me minimalisht 45% të vlerësimit total apo 45 pikë.

PROVA FINALE: Provim me shkrim në fund të semestrit

LITERATURA

a) Literatura bazë e detyrueshme:

Rapti, E. Psikologji Shkollore, Tiranë 2004

Cikël leksionesh

b) Literatura e rekomanduar:

Μετοχιανάκης, Η. (2008). Εισαγωγή στην Παιδαγωγική Α'. Ηράκλειο: Αυτοέκδοση. 2.

Ξωχέλλης, Π. (2010). Εισαγωγή στην Παιδαγωγική. Θεμελιώδη προβλήματα της

Παιδαγωγικής Επιστήμης. Θεσσαλονίκη: Αδελφών Κυριακίδη ΑΕ.

Materiale nga interneti

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS

Studentet janë të detyruar të veprojnë në përputhje me dhe të respektojnë në mënyrë rigorozë

teresine e rregullave, pritshmerive dhe sanksioneve perkatëse të parashikuara në rregulloren e

UGJ-se për t'u sjelle me integritet akademik mbështetur në ndershmëri.

Studentet janë të detyruar :

- Të mos kopjojnë apo japin kopje në provim
- Të mos kopjojnë dhe paraqesin punën e dikujt tjetër

- Te mos fabrikojne apo manipulojne te dhenat
- Te respektojne integritetin dhe dinjtetin njerezor & professional te personelit akademik dhe atij ndihmes
- Te respektojne integritetin dhe dinjtetin njerezor & professional testudenteve te tjere

Ne raste shkeljesh te ketyre rregullave studentet penalizohen sic parashikon rregullorja e UGJ-se dhe rregullorja e programit te studimit.


**PËRGJEGJËSI I NJËSISË BAZË TË EDUKIMIT DHE METODOLOGJISË SË
MËSIMDHËNIES**

Doc. Dr. MIMOZA ÇARKA



PROGRAMI I LËNDËS

LËNDA:KËRKIMI NË EDUKIM

Titullari /pedagogu i lëndës: Loreta MAMANI Dr 
Ngarkesa: 6(ECTS), 60 orë në auditor (2/2); 30 leksione dhe 30 seminare
Viti akademik/semestri kur zhvillohet: 2022-2023, viti i parë, semestri II
Lloji i lëndës: E detyruar

Programi i studimit: Master në “Mësuesi në Arsimin e Mesëm të Ulët, Biologji-Kimi”

Adresa elektronike e titullarit/ pedagogut të lëndës: loretamamani@hotmail.com

Kodi i etikës: Pedagogu dhe studenti duhet të respektojë rigorozisht tëresinë e rregullave, pritshmërive dhe sanksioneve përkatëse të parashikuara në rregulloren e UGJ-së dhe të programit të studimit.

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Metodologjia e kërkimit shkencor në shkencat e edukimit ka për qëllim të ofrojë mundësinë se si përdoren teoritë dhe teknikat e ndryshme (dhe si ndërveprojnë ato së bashku) për të na ndihmuar të mendojmë për mënyrat se si mund ta zhvillojmë hulumtimin. Kërkimi është një proces sistematik i mbledhjes dhe analizimit logjik të të dhënave për disa qëllime. Karakteristikat e kërkimit në edukim janë objektive, precize, të verifikueshme, të shpjegueshme, empirike, logjike dhe të kushtëzuara. Kërkimi kuantitativ dhe kualitativ, ndryshojnë në supozimet rreth botës, qëllimin e kërkimit, metodat e kërkimit dhe procesi, studimet prototip, roli i kërkuesit, dhe rëndësia e kontekstit në studim. Kërkimi bazik teston teoritë dhe shpjegon lidhjet empirike dhe analitike në shkencat fizike, të sjelljes, dhe sociale. Kërkimi i aplikuar teston dobishmërinë e teorive shkencore në një fushë të aplikuar dhe investigon lidhjet dhe përgjithësimet analitike të zakonshme për një profesion të dhënë. Cilësia e një studimi varet nga dizaini dhe metodat, jo nga lloji i kërkimit. Edukimi është një fushë ndërdisiplinore e kërkimit ku, kërkuesit huazojnë koncepte, teori, dhe metodologji nga disipinat dhe i aplikojnë ato në edukim. Kjo lëndë do ti paisë studentët me aftësi dhe kompetencatë tilla si: zhvillojë shprehje praktike dhe etike në kërkimin cilësor në edukim; Të kuptojnë se si pikëpamjet personale ndikojnë në disenjimin e kërkimit shkencor; Të konkretizojnë dijet e tyre mbi kërkimin cilësor në një studim konkret të vlefshëm; Të përdorin intervistën, studimin e rastit, vëzhgimin e pjesëmarrësve dhe teknikat e vëzhgimit natyror për mbledhjen dhe analizën e të dhënave; Të përdorin videon dhe teknologjinë për të mbledhur dhe analizuar të dhënat; Të analizojnë në mënyrë kritike anët positive dhe negative të kërkimit cilësor; Të paraqesin një studim të plotë sipas formatit të dhënë; Të bëjnë një prezantim profesional në klasë.

Pas përfundimit të lëndës studentët do të jetë në gjendje të:

- Të kuptojnë natyrën e kërkimit shkencor, klasifikimin, vlefshmërinë, dhe besueshmërinë e tij.
- Të njohin konceptet bazë të metodologjisë së kërkimit shkencor.

- Të dallojnë kërkimin shkencor edukativ nga kërkimi i çfarëdoshëm, njohjen e tyre me format e ndryshme të kërkimit dhe teknikat e tij,
- Të demostrojnë mënyrën se si zgjidhet problematika e kërkimit.
- Të identifikojnë dhe emërtojnë variablat e kërkimit shkencor.
- Të marrin njohuritë fillestare të analizës së të dhënave.
- Të ndërtojnë pyetësorë, testeve të matjes si dhe të shkruajnë një raport të kërkimit.

KONCEPTET THEMELORE:

1. Karakteristikat e kërkimit shkencor.
2. Identifikimi dhe emërtimi i variablave të kërkimit.
3. Ndërtimi i hipotezave.
4. Popullata dhe kampioni i studimit.
5. Metodatat dhe teknikat e kërkimit.
6. Kërkimi eksperimental.

TEMAT E LËNDËS

